

PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 23/03/2026
PRIMLJENO:
02/86
NUMERI:



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi Komunal Malishevë

PROCESVERBAL

i mbledhjes së-I- (parë) të rregullt të Kuvendit Komunal të Malishevës

RENDI I DITËS

1. Dhënia e betimit të anëtarëve të Kuvendit Komunal, z. Astrit Sertolli, z. Skender Zogaj dhe z. Hamëz Bytyçi.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -I- (parë) inauguruese të KK-Malishevë, datë: 03.12.2025, Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -I- (parë) të jashtëzakonshme të mbajtur me datë: 30.12.2025, Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -I-(parë) urgjente të mbajtur me datë: 12.01.2026, Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -II-(dytë) të jashtëzakonshme të mbajtur me datë: 20.01.2026.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/448 datë:02.03.2026 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, në lidhje me kërkesën e Shoqatës Bamirëse “Jetimat e Ballkanit” për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Komunës së Malishevës nr.02/359, datë:11.08.2022.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/390 datë:23.03.2026 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, për formimin e Komisionit Vlerësues, me rastin e dhënies në shfrytëzim të pronës publike përmes thirrjes së interesit publik sipas vendimeve të Kuvendit nr.02/121, datë:08.03.2024 dhe nr.02/142, datë:23.05.2025
5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 01/391, datë 23.02.2026 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, për formimin e komisionit të ankesave, konform nenit 18, të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/451 datë:03.03.2026 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, për miratim të listës së pronave të paluajtshme të komunës së Malishevës, për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026.
7. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Komunal nr.01/459, datë: 04.03.2026 mbi Vlerësimin e Dëmeve nga FNFT.
8. Formimi i Komisionit për Hartimin e Planit të Punës së Kuvendit.
9. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/459, datë:04.03.2026 për Themelimin dhe emërimin e anëtarëve të KKSB-së për Komunën e Malishevës.
10. Formimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve “Stacioni i Autobusëve” SH.A. Malishevë.

11. Formimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve "EKO-Regjioni" SHA.A Prizren, njësia në Malishevë.
12. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për ngritje të tarifës së shërbimit të mbeturinave.
13. Formimi i Komisionit për ndryshim-plotësim të Statutit të Komunës.
14. Formimi i Komiteteve jo obligative.
15. Formimi i Komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale.
16. Propozim- Formula për zgjedhjen e delegatëve të Komunës për Kuvend të AKK-së.
17. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 12.03.2026 dhe filloi në ora:10:15.

Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: 17 asamblastë, Kryetari i Komunës z.Ekrem Kastrati,Nënkryetari i Komunës z.Vesel Krasniqi,Drejtori për Administratë të Përgjithshme z.Argjend Thaçi,Drejtori për Ekonomi dhe Financa z.Blerim Thaçi, Drejtori për Gjeodozi dhe Kadastër z.Rifat Mazreku,Drejtori i Inspektoriatit z.Jakup Gashi,Drejtoresha për Kultur,Rini dhe Sport znj.Teuta Miftari–Mazreku,Drejtori për Shërbime Publike z.Izet Hoti,Drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim z.Nuredin Hoxha,Drejtori për Urbaznizëm z.Avdi Morina,Drejtoresha për Arsimit dhe Edukim znj.Arbëreshë Krasniqi,Drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale z.Amrush Helshani,Drejtori për Bujqësi,Pylltari dhe Zhvillim Rural z.Sylë Dukolli,Drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm z.Arbër Kastrati,Drejtoresha për Prona znj.Mirlinda Gashi,përfaqësues nga OSBE-së si dhe zyra për informim.

Munguanë z.Albrim Morina nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës dhe z.Arben Krasniqi nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje.

Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Malishevës z.Fatmir Ademaj.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Të nderuar antarë të Kuvendit Komunal të Malishevës jemi në mbledhjen e parë të rregulltë të Asamblesë Komunale,rendin e ditës materialin e keni pranuar me kohë, e lusë sekretarinë e Kuvendit të konstatojë a kemi korum të mjaftueshëm për vazhdimin e seancës.Të pranishëm janë 17 antarë të asamblesë dhe kushtet janë plotësuar për vazhdimin e seancës së parë të rregulltë të Asamblesë Komunale në Malishevë.

Para se me filluar me rendin e ditës sot i kemi tre antarë të rinjë të Kuvendit për të dhënë betimin për shkak të vendimit të ekzekutivit Kryetari i Komunës ka emëruar tre Drejtorë dhe janë lëshuar

tre vende të Asamblesë Komunale na rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate,tre antarët i kemi prezentë këtu.

Unë do ta lexoj betimin së bashku me ata dhe ne i urojmë mandatin e ri.

Atëherë unë do të fillojë duke e lexuar betimin me zë dhe ju e përsëritni njëjtë dhe kështu do të përfundojë procedura e betimit.

Unë betohem ose deklarojë solemnishtë se do të kryejë detyrat me nderë besnikëri pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit do të ushtrojë autorizimet e mija si antarë i Kuvendit Komunal të Malishevës në mënyrë që të sigurohen kushtet për jetë për të gjithë qytetarët betohem.

Një zëri pohuanë dhe u betuanë tre antarët e rinjë z. Astrit Sertolli, z.Skender Zogaj dhe z. Hamëz Bytyçi.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Urime mandati.Para se me filluar me rendin e ditës kemi kohë tridhjetë minuta kohë për deklarime jashtë rendit të ditës urdhëroni e hapi debatin.

Hafir Rexha(antarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Përshëndetje Kryesus,Drejtorë të ekzekutivit,antarë të Kuvendit,koleg dhe kolege,media si dhe qytetarë të nderuar,i nderuar Kryetar para se me filluar me rendin e ditës,kërkojë nga ju dhe sekretari që të na pajisni me mjete të konkretizimit në këtë rast me llaptop në mënyrë që në mbledhjet e tjera të vijmë më të pregaditurë sepse materialet na kanë ardhur në email mirëpo nuk kemi pasur mundësi dhe hapësirë ndoshta me shtjelluar.

Qështja e dytë me të cilën dëshirojë ta ngrisë është për ekzekutivin për Kryetarin edhe Drejtoritë përkatëse rruga:Lumishtë,Turiak,Panorc,Rud,Llapqevë të cilat i lidh me tri komunat e tjera Klinën,Gjakovën edhe Rahovecin janë në gjendje të mjerueshme.

Unë e di që është barë dhe përgjegjësi e nivelit qëndrorë por kërkojë nga ekzekutivi gjegjësishtë nga drejtoritë përkatëse që të bëjnë kërkesë që të bëjnë presionë pozitiv në Qeverinë e Kosovës që kur të bëhet rishikimi i buxhetit ajo të paktën të hyjë për renovim,rregullimë të saj në të kundërtën është e pa kalueshme.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit shumë.A ka dikush me marrë fjalën?Urdhëro z.Bashkim.

Bashkim Krasniqi(antarë nga rradhët e parties Nisma Socialdemokrate):Faleminderit Kryesus.Të nderuar koleg Asambleistë,Drejtorë të drejtorive komunale,shfrytëzojë rastin që të ju uroj të gjithëve punë të mbarë gjithashtu edhe tre asambleistëve që e dhanë betimin mirë se keni ardhur në ekipën tonë,të nderuar media dhe ju gjithë qytetarëve të Malishevës.

Unë dëshirojë të diskutojë për dy qështje. E para ne e kemi parashtruar një ankesë në inspektoriat edhe në polici por e kemi dërguar si ankesë pasi që është në Ministrinë përkatëse lidhur me qarkullimin e peshave të cilat janë jashtëzakonishtë të rënda të cilat janë duke ndodhur për momentin në rrugën tonë,rruga "Afrim Krasniqi"që e lidh me fshatinë Tërpezë dhe kalonë deri në Kleqkë te varrezat e dëshmorëve e tutje,do me thënë që brenda ditës janë afërsishtë pesëdhjetë apo gjashtëdhjetë kamiona që qarkullojnë dhe ata kamiona apo firma i përkasinë komunave të ndryshme nuk do ti ceku me emra sepse ne nuk jemi kundër asnjë subjekti juridik mirëpo kërkojë që të mirën masa edhe pse e dimë që kompetencat e komunës janë të kufuzuara me i ndaluar këto gjëra por të mirën masa të bëjnë presionë në institucione qëndrore në mënyrë që vijnë deri te një kufizimë i peshës deri në këtë rrugë përndryshe përveq që do të mbesim pa rrugë sepse dëmtimet janë shumë të mëdhaja është rreziku që mundë të ndodhë fatëkeqësi duke e pasur parasysh terrenin që është në fshatin tonë.

Qështja tjetër,ne e dime që këtë vitë kemi pasur zgjedhje edhe buxheti është miratuar me vonesë,ndoshta ka mungesë edhe të mjeteve kërkojë për një kontratë që është valide kërkojë që të ekzekutohet në të gjitha fshatrat dhe mos të ketë diferencim aq të madhë të fshatrave por të jenë të ndriquara të gjitha rrugët.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit.Veton Zogaj e ka këruar fjalën pastaj znj.Valjeta.Urdhëro z.Veton.

Veton Zogaj(antarë nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosja):Faleminderit Kryesus. Përshëndetje kabinetë qeveritar,përshëndesë tre kolegë që u bashkangjitën sot shpresojë që të ju shkojë mbarë së bashku me neve.

E para unë do të fokusohem sot në fushën e shëndetësisë,të cilat kam pasur me i ngritur më parë mirëpo në mandatin e kaluar gjysëm mandati nuk kemi pasur drejtorë kurse tani e kemi drejtorin shpresojë që ka me filluar me i marrur masat atje.I nxitur prej disa raportimeve mediale të cilat i kam parë kohët e fundit ma jepë një përshtypje që situata në QKMF(Qendra Kryesore e Mjekësisë

Familjare) në Malishevë nuk është fare e mirë, kam informacioneve të sakta prej QKMF-së në Ambulancë veturat zyrtare nuk kanë bërë servisim që një kohë të gjatë, përveç saj ato edhe paraqesin rrezik për pacientët që i bartin me i dërguar në QKUK kjo që është dashur të rregullohej me kohë që mos të ketë probleme të tilla.

Qështja tjetër shqetësuese është kontrata me kompaninë e cila kryenë shërbime shëndetësore jam duke u bazuar prej informacioneve të sakta prapë po e theksojë por edhe nga raportet mediale shumica e puntorëve aty që punojnë nuk janë profesionistë shëndetësorë dhe janë të punësuarë në institusione tjera pra marrin kontratë për kryerjenë e shërbimeve në QKMF ndërsa punojnë krejtë diqka tjetër por besojë që është mirë Drejtorë që në mbledhjen tjetër me na sjellur listën se kush janë ata që janë të angazhur në këtë kompani me këtë lloj kontrate.

Qështja tjetër është siq e dini edhe ju kanë kaluar dy vite që është shpallur konkursë publik për infermierë dhe mjekë dhe është anuluar pa asnjë arsytim prej Komunës, janë afërsishtë mbi pesëmbëdhjetë vende të lira të punës të cilat nuk hapen përmes konkursit publik të rregulltë që të angazhohenë profesionistë shëndetësorë aty kurse në anën tjetër komuna lidh kontrata tjera për kryerjenë e shërbimeve të njejta për infermierë kurse është për mjekë është mirë me ditë sa vende të lira të punës janë aty dhe pse zvaritet nuk hapet konkursi publik për angazhimin e punëtorëve?

Dy që është të tjera ndoshta janë teknike por janë shumë të rëndësishme. Unë e di që sipas ligjit për shëndetin publik Drejtori i qendrës së mjekësisë familjare duhet të ketë kualifikimin së paku specialist i mjekësisë familjare.

Drejtorë ju e keni parë se kë e kemi Drejtor aty dhe qfarë kualifikimi ka i cili bie ndeshë është mirë me marrë masa dhe ju me tregu vetën.

Kërkojë falje që sot po ju drejtohem kështu por unë mundë të themë vetëm si udhëzim, e para e punës është që duhet me u shkarkuar Drejtori aktual sepse është shkelje ligjore ai e ka vendin e punës aty por jo si Drejtor i QKMF-së po ashtu edhe pozita tjetër kordinator i cilësisë ligji e thotë që duhet të jetë së paku bachelor i infermierisë është një personë aty që është jashtë asaj fushe është teknik dhe nuk përkonë me realitetin aty.

Sa i përketë papastërtisë nivelit dhe kushtet sanitare aty e keni parë edhe ju vetë nuk kam qfarë me shtuar është mirë me i marrë masat dhe me përmirësuar gjendjen. Faleminderit shumë.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Veton.Para se me filluar me antarët e tjerë të Kuvendit meqenëse ishte z.Vetoni duke folur nuk deshta me ndërpre,shifat e grupit të drejtorëve sipas rregullorës së punës së Kuvendit kanë të drejtë në minuta të mbajnë fjalim jashtë rendit të ditës,dy minuta për antarët e Kuvendit sipas nenit 26 të rregullorës së punës së Kuvendit,kështu që ju sygjerojë ta respektoni minutazhin nga rregullorja e punës.Valjeta Hoti e ka fjalën.Urdhëro.

Valjetë Hoti(antare nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës):Faleminderit Kryesues.Përsëritje për të gjithë,unë kam dy qështje për të ngritur por para se të fillojë me qështjet të cilat kam me i ngritur,unë dua ta bëjë një kritikë direkte sepse është për keqardhje që Komuna jonë festën e 8 Marsit nuk e ka shenuar me ndonjë aktivitet kjo na lenë një përshtypje jo të mirë dhe na krijonë një bindje që Komuna jonë qështjet për barazi gjinore nuk i trajtonë me dinjitet dhe mënyrën ashtu si e meritojta.

Premtimet duhet me i përcjellë edhe në veprime konkrete sepse Komuna si institucioni më i lartë përveq se duhet të ketë përgjegjësi duhet me qenë edhe shembullë për promovimin e vlerave po ashtu nuk është edhe prej atyre datave që kërkonë ndonëse e ka vlerën e madhe,nuk kërkonë ndonjë organizim madhështorë por ka mundur të shenohet edhe me një tryezë diskutimi,ka mundur të shenohet edhe me nderime për grat që kanë dhënë kontribut në Komunën tonë sepse nuk janë të pakta.

Qështja tjetër është bursa,besoj që ka ardhur koha që studentëve ti jepet një përgjigje e kjo sepse jo të gjithë e kanë ndjekur seancën për buxhet dhe nuk janë në dijeni për mos përfshirjen e tyre në buxhetin komunal edhe duke u bazuar nga praktikat e kaluara do me thënë që nga viti 2022 Komuna nuk ka ndarë bursa,zakonishtë aplikimet janë hapur në muajin Mars dhe shumica e tyre janë në pritje,kështu që kërkojë nga Komuna të dalë me një qëndrim,me një njoftim zyrtar a do të ketë bursa apo jo.

Qështja tjetër e cila ndërlihet me sallën e Kuvendit.Kryesues kur pritet të rregullohet kjo sallë?Kjo nuk është në nivelin e duhur duke e pasur parasysh që këtu kryhet një punë e madhe është një investim i domosdoshëm.A pritet të ndodhë?Faleminderit.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit znj.Valjeta.Fjalën e ka kërku z.Burim Paqarizi.Urdhëro.

Burim Paqarizi(antarë nga rradhët e Partisë Demokratike):Përsëritet Kryesus,Drejtor komunal,të dashur qytetarë të Komunës së Malishevës,përsëritet edhe për juve koleg Asambleistë,përsëritet Kryetar dhe Nënkretar.

Para se me filluar me fjalën i urojë të gjithë besimtarëve të besimit Islam muajin e shenjtë të Ramazanit,pastaj edhe Festën e Bajramit e cila është në fund të javës tjetër.Unë do të ndërlidhem me dy,tri qështje para fillimit të kësaj seance.

E para ka të bëjë me nivelin e mirëmbajtjes së rrugëve të cilat pas sezonës dimërore janë në gjendje të mjerueshme,urojë që Drejtori i Urbanizmit ka vazhdimin e mandatit të drejtorisë ai e din nivelin e tyre dhe të fillojë sa ma shpejtë me sanimin e atyre gropave sepse rrugët janë bërë në gjendje të mjerueshme dhe të pa kaluara për qytetarët,janë dëme jashtëzakonisht të mëdhaja.

Pastaj është një temë tjetër që unë në dy mandate në vazhdimësi e përmendi është ndriqimi publik ne tashmë e dimë që kontrata për ndriqimin publik është aktive,urojë që tani më operatori publik pasi ka filluar rregullimi i kushteve klimatike edhe punët të jenë më të lehta në terrenë,të vazhdojë me punët sa më shpejtë, e dini se tani qytetarët në vazhdimësi janë duke dalur me bërë lëvizje dhe ecje të një pas njëshme dhe në mënyrë që mos të ketë rrezik sepse kemi probleme të vazhdueshme ku qytetarët po kanë probleme gjatë lëvizjesë.

Një temë e rëndësishme ku ka shumë vërejtje është te projekti tek pjesa e tranzitit ku janë kufizuar lëvizjet për mjetet e rënda,pra kemi shumë ankesa prej qytetarëve dhe ju Kryetarë duhet me bërë një zgjedhje në mënyrë që atyre me ja lehtësuar lëvizjen,rruga e cila kalonë nga Komuna mbrapa stacionit të autobusave është në gjendje jashtë zakonishtë të keqe dhe ata po kanë në vazhdimësi dëme.

Duhet me bërë një mënyrë dhe një qasje se a duhet me lejuar kalimin e tyre në nënkalim apo me ja rregulluar mundësinë se si me lëvizur ata?Gjithashtu rreth rrotullimi te stacioni i policisë është jashtë zakonishtë i ngushtë.

Gjithashtu edhe një vërejtje prej qytetarëve në fshatin Guriq kanë jashtë zakonishtë probleme me kanalizim është mirë që një ekip sa ma shpejtë të dalë në terrenë ku një pjesë e qytetarëve kanë dëmtime te pjesa e pemëtarisë duhet menjëherë me dalur në terrenë sepse gjendja është e keqe dhe ata kanë pengesa të mëdhaja prej kanalizimit dhe është vështirësuar jeta e tyre.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Burim.A ka dikush shqetësime apo pyetje nga antarët e Kuvendit?Fjalën e ka kërku z.Fitim Shala.Urdhëro.

Fitim Shala(antarë nga rradhët e partisë Lidhja Demokratike e Kosovës):I nderuar Kryesus,Kryetar,Nënkryetar,Drejtor dhe ju Asambleistë,media dhe ju qytetarë të Komunës së Malishevës. Duke e ditur faktin që e kemi votuar buxhetin komunal në këtë asamble,dua të bëjë pyetje se kur do të fillojnë procedurat e prokurimit?

Për projektet që ne si asambleistë i futurë në atë buxhetë për arsye qe shumë projekte esenciale për qytetarët i kemi future në atë buxhet dhe presim të ekzekutohen.

Një qështje tjetër që dua të ndërlidhem janë për subvencionet në bujqësi e kam parë që ka shumë shpallje për makineri bujqësore.Kjo për bujqësorët tanë është shumë e mirë qfarë është duke ndodhur e di që ka partneritete me organizata të huaja.

Por a ka mundësi që Drejtoria e Bujqësisë ta formojë një komisionë të monitorimit që këto subvencione kur të ipen të monitorohenë së paku për dy vite që mos të ipet mundësi keqpërdoruesëve ti shesin ato subvencione pasi të përfitojnë nga Komuna.

Gjithashtu unë e di që Komuna e Malishevës e ka një vendim që ndanë shtesa në shumën prej 100€ për nënat lehona mirëpo si pasojë e mungesës së buxhetit ka kohë që nuk kanë ndarë këto pagesa.Një pyetje për Drejtorin se kur do të fillojnë të ekzekutohenë këto pagesa?Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit.A ka dikush tjetër me marrë fjalën.Halil Morina e ka kërku fjalën.Urdhëro.

Halil Morina(antarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Faleminderit Kryesues për fjalën.Të nderuar koleg Asambleistë.I urojë mirëseardhje Hamëzës,Astriti,Skenderit,mirëse keni ardhur në Kuvend shpresojmë që të gjithë së bashku këtu e së bashku me qeverinë komunale urime edhe juve mandatin e ri,shpresojë që këto dy anët ekzekutivi dhe legjislativi të dyja së bashku të bëjmë punë të mira për qytetarët e Komunës tonë.

Dëshirojë vetëm shkurtë, ma kujtove Kryesues kur e përmende rregullorën se shefave të grupeve ju lejonë kaq minuta,e antarëve kaq minuta.Në seancën e kaluar e kam bërë si kërkesë që antarëve me ju sjellë rregullorën në Kuvend,në mënyrë që secili antarë i Kuvendit me qenë i njoftuar me

pasur të ditur se sa ka të drejtë me fol,qfarë ka të drejtë me folur,qfarë qështje ka të drejtë me ngritur.

Pastaj nëse ne e shohim që në atë rregullore ka diçka që duhet me ndryshuar apo nuk është kompakte me atë punën dhe angazhimin tonë atëherë ajo ndryshohet sepse ajo është miratuar nga Kuvendi dhe prapë ndryshohet nga Kuvendi dhe pastaj kur secili prej neve e ka rregullorën e dinë sa ka të drejtë me folur e dinë se qfarë qështje ka të drejtë me ngritur jashtë rendit të ditës.

Ngriten qështje konkrete specifike sepse për qështje gjenerale për problemet që janë në Komunën tonë ne mundemi secili prej neve me ngritur.Komuna e Malishevës gjithmonë ka me pasur dikunë rrugë të prishura,rrugë të pa ndriqara dhe ne nëse dalim dhe flasim për secilin shqetësim në mënyrë gjenerale atëherë neve na merrë kohë afërsishtë dy ose tri orë kjo qështje jashtë rendit të ditës e që me rregullore është e përcaktuar vetëm tridhjetë minuta.

Kështu që në seancën e ardhshme për me menagjuar kohën më mirë është mirë që secili prej antarëve të Kuvendit me pasur rregullorën edhe me shikuar atë rregullore më mirë edhe me lënë ashtu siq është apo me ndryshuar .Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Halil.A ka dikush nga antarët e Kuvendit ndonjë shqetësim apo kërkesë?Atëherë nëse nuk keni pyetje ,tri pyetje të cilat janë parashtruar dhe janë drejtuar Kuvendit për fjalë ja kalojë Kryetarit të ekzekutivit Kryetarit të Komunës z.Ekrem Kastrati.

Qështja e parë është ngritja e llaptopëve e vlerësojë që secili subjek politik duhet ta trajtojë në mënyrë serioze për qështjen e antarëve të vetë, për shkakë që secili subject politik këtu nuk i ka përmbushur obligimet nga antarët e tyre,sot nuk do ti përmendi emrat e antarëve të Kuvendit të cilët nuk i kanë kthyer llaptopat,pasi që Sekretari e Kuvendit disa herë ju ka dërguar thirje por edhe mesazhe për kthimin e llaptopëve,nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës janë pesë antarë që nuk i kanë kthyer llaptopat,nga rradhët e partisë Lëvizjes Vetëvendosje janë dy antarë që nuk i kanë kthyer llaptopat,nga rradhët e partisë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës një antarë e ka që nuk e ka kthyer llaptopin,nga rradhët e Nisma Socialdemokrate janë katër antarë që nuk i kanë kthyer llaptopët,nga rradhët e partisë Lidhjes Domokratike të Kosovës janë dy antarë që nuk i kanë kthyer llaptopët.

Kërkojë nga subjektet politike që në kordinim me antarët e tyre deri të hënën ti kthejnë të gjithë llaptopët dhe të pajisen asambleistët e rinjë.

Në të kundërtën do të publikohen emrat e antarëve të cilët nuk e kanë kthyer llaptopinë, nëse nuk e kthejnë pastaj do të veprojmë ashtu siq e parasheh ligji.

Valejta te qështja e rregullimit të sallës së Kuvendit kjo tani është në procedurë të ekzekutivit dhe besoj që muaji shtator do të na gjejë me sallë të re.

Halil te qështja e Rregullorës së Kuvendit besoj që të gjithë antarët e Kuvendit e kanë përpara në tavolinë materialin, besoj që pas ndryshimit të Statutit të Komunës së Malishevës ka nevojë për ndryshim edhe Rregullorja e Kuvendit mirëpo pa filluar ndryshimi i Statutit të Komunës së Malishevës nuk do të fillojë një dëgjim i tillë për Rregullorën e Kuvendit.

Fjalën ja kalojë Kyetarit të Komunës z. Ekrem Kastrati.

Kryetar i Komunës z. Ekrem Kastrati: Faleminderit Kryesus. Më lejoni që të ju urojë një ditë të mbarë është legjislatura e tetë e Asamblesë Komunale, ju dëshirojë tre Asambleistëve të ri z. Astrit Sertolli, z. Skender Zogaj dhe z. Hamez Bytyqi punë të mbarë dhe suksese në arritje në objektivat e juaja dhe të qytetarëve sepse ne jemi të thirrur që të përfaqësojmë interesat e qytetarëve.

Fillimishtë unë deshta të marrë fjalën jo jashtë rendit të ditës mirëpo në mbledhjen e kaluar e mora si obligim që kur të themelohet qeveria komunale të më jepet mundësia që të prezantojë drejtusit e digastereve përkatësishtë drejtorive që i ka Kuvendi Komunal.

Sot kam nderim dhe kënaqësin që para juve të prezantojë kabinetin tim qeverisës ekipin për të cilën do të punojmë për zhvillimin e Komunës së Malishevës.

Ky ekip përbëhet nga profesionistë të fushave të ndryshme të cilët kanë përvojë në institucione kanë përkushtim ndaj shërbimit publik me të cilën do të angazhohenë për realizimin e projekteve, prioriteteve tona.

Fillimisht më lejoni të prezantojë **Nënkryetarin e Komunës së Malishevës z. Vesel Krasniqi** i cili me profesionë është ekonomistë me përvojë të gjatë në administratë publike dhe në nivel qëndror. Karrierën e tij e ka zhvilluar në Administratën Komunale si Zyrtatë i Turrizmit ndërsa më pas ka shërbyer si shef i Inspektoriatit dhe shef i thesarit në Drejtori për Ekonomi Buxhet dhe

Financa ai ka udhëhequr këtë drejtori si Drejtor dhe më pas ka kontribuar edhe në nivel Qëndror si Zëvendës Ministër në Ministrinë e Bujqësisë Pyltariisë dhe Zhvillimit Rural dhe si Ministër i Tregëtisë dhe Industrisë në Qeverinë e Republikës së Kosovës me këtë përvojë të gjatë jetësore ai do të jep një mbështetje të rëndësishme në kordinimin e punës së Komunës tonë.

Drejtoreshë për Arsim dhe Edukim do të jetë zonja Arbëreshë Krasniqi niveli i arsimit: Master i Psikologjisë dhe me përvojë të gjatë në institucione politike të vendit. Ajo ka shërbyer si Deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës, gjithashtu edhe si Zëvendëse e Ministrit të Tregëtisë dhe Industrisë po ashtu ka ushtruar detyrën si drejtoreshë në Drejtorinë e Arsimit në Komunën e Malishevës duke dhënë kontribut në zhvillimin dhe avancimit e sistemit arsimor në Komunën tonë.

Drejtor për Ekonomi Buxhet dhe Financa do të jetë zotri Blerim Thaqi: profesor në lëndën e Matematikës me përvojë të gjatë në arsim dhe në institucionet e Komunës tonë, ai ka shërbyer si mësues në "Gjimnazin " Hamdi Berisha " në Malishevë dhe ka qenë Antarë i Kuvendit Komunal në institucione në nivelin komunal në pozita drejtuese i cili ka udhëhequr Drejtorinë për Arsim dhe Edukim, në Drejtori për Gjeodozi dhe Kataster, dhe Shërbime Pronësore-Juridike.

Në krye të Drejtorisë për shërbime Shëndetësore dhe Mirëqenie Sociale do të jetë zotri Amrush Helshani i diplomuar në Fakultetin Filozofikë, Drejtor i Qendrës Rinore në Malishevë dhe ka shërbyer si Asambleistë në Kuvendin Komunal në Malishevë është vlerësuar për performancën si Asambleistë i Kuvendit.

Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm do të jetë zotri Avdi Morina i diplomuar në drejtimin: Master Juridiko-Civil një figurë e përkushtuar për zhvillimin e qytetit të Komunës së Malishevës, ai ka shërbyer si Asambleistë në Komunën e Malishevës, gjithashtu ka ushtruar detyrën e Drejtorit në Drejtorinë e Arsimit dhe Edukimit në Komunën tonë, gjithashtu ka udhëhequr projekte të rëndësishme infrastrukturore dhe urbane duke dhënë kontribut të madhë në zhvillimin dhe planifikimin e Komunës tonë.

Në krye të drejtorisë Drejtorië për Administratë të Përgjithshme do të jetë zotri Argjend Thaqi është Jurist i diplomuar ai ka ushtruar detyrën e Kryesuesit të Kuvendit në Asamblenë Komonale i cili ka dëshmuar angazhim dhe përgjegjësi në drejtimin e punës së Kuvendit në kordinim në proceset vendim marrëse lokale, ndërkohë përvoja dhe njohja e tij në fushën

institucionale administrative do të kontribojë në efikasitetin dhe përmirësimin e shërbimeve për qytetarët.

Drejtor në Drejtorinë e Inspektoriatit do të jetë zotri Jakup Gashi i diplomuar në Master i Shkencave Juridike dhe Teolog, ai ka përvojë të gjatë në Arsimit si profesorë në lëndën juridike në shkollën profesionale "Lasgush Poradeci" në Kijevë si dhe angazhim të vazhdueshëm në aktivitete shoqërore.

Në krye të Drejtorisë për Gjeodozi dhe Kadastër do të jetë zotëri Rifat Mazreku i diplomuar në Shkencat e Sigurisë me përvojë në menaxhimin dhe zhvillimin e punëve komunale, ai gjithashtu ka ushtruar detyrën në Drejtorinë e Shërbimeve Publike në Komunën e Malishevës duke fituar përvojë të rëndësishme në administrimin e shërbimeve komunale dhe në punën me bashkëpunim me qytetarët.

Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural do të jetë zotri Sylë Dukolli i cili është ekonomistë i diplomuar dhe veteranë i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ai është dalluar për kontributin e tij për të mirën e përbashkët dhe për lirinë e vendit. Ndërsa në angazhimet e tij institucionale ka dhënë një mbështetje të fuqishme për fermerët në sektorin bujqësorë të Komunës së Malishevës.

Në krye të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport do të jetë zonja Teuta-Miftari-Mazreku e diplomuar në Master i Shkencave Spotive në Universitetin e Prishtinës. Ajo ka një përvojë të gjatë në arsim si mësime dhënëse në Qendrën e Kompetencës "Kujtim Krasniqi" në Malishevë.

Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike do të jetë zotri Izet Hoti i diplomuar në Master i Sociologjisë me një përvojë të gjatë në menaxhimin institucional, ai ka shërbyer edhe si Drejtor në Gjinnazin "Hamdi Berisha" në Malishevë i cili është i njohur për angazhimin e tij në administrimin publik dhe zhvillimin e institucioneve lokale.

Në krye të detyrës si Drejtor për Mbrojtje dhe Shpëtim do të jetë zotri Nuredin Hoxha i cili është inzhinier i komunikacionit rrugorë me përvojë në fushën e infrastrukturës rrugore si inspektor i infrastrukturës rrugore.

Ndërsa në krye të detyrës si Drejtor i Zhvillimit Ekonomik dhe Turizëm do të jetë zotri Arbër Kastrati i cili është ekonomistë i diplomuar në Fakultetin Ekonomik të Prishtinës në drejtimin

Banka Financa dhe Kontabilitet ai ka përvojë pune në sektorin privat si menaxher si dhe kordinator në Agjensionin për Zhvillim Rajonal.

Drejtoreshë për Pronë do të jetë zonja Mirëllinda Gashi e cila është juriste e diplomuar në nivelin Master Civil, ajo ka përvojë të madhe si mësimdhënëse në Qendrën e Kompetencës "Kujtim Krasniqi" dhe ka shërbyer si antare e Kuvendit në Malishevë dy mandate.

Të nderuar antarë të Kuvendit jam i bindur se ky ekip do të punojë me përkushtim, transparencë dhe përgjegjësi për të realizuar projektet dhe prioritetet zhvillimore të Komunës tonë.

Bashkëpunimi dhe dialogu me qytetarët tonë do të jenë parimet kryesore të qeverisjes tonë.

Së bashku do të punojmë për një Malishevë më të organizuar dhe me më shumë mundësi për qytetarët e Komunës tone, njëkohësishtë kërkoj që të kemi një bashkëpunim më të thellë dhe më të mirëqentë me Asamblenë Komunale sepse ne të gjithë jemi të thirur në realizimin e interesave të gjithë qytetarëve.

Besojë që një bashkëpunim i ekipit që prezentova dhe i legjislativit përkatësishtë përfaqësuesit e kësaj Asambleje të cilët i vlerësoj shumë, besoj që një bashkëpunim i mirë do të na shoqëroj gjatë këtij mandati katër vjeçar.

Meqenëse isha prezentë dhe i ndëgjova diskutimet nga disa antarë të Kuvendit po e shfrytëzoj rastin të përgjigjemë, nëse me jepet mundësia.

Mirëmbajtja e rrugëve e cila ishte njëra prej diskutimeve që u ngritë nga një Asambleistë i nderuar, kontratën që e kemi pasur ka përfunduar, besoj që në vazhdimë e sipër ne do të themelojmë një kontratë së re për mirëmbajtjenë e këtyre rrugëve ashtu siq e kemi para parë me projekt buxhet.

Ndriqimi publikë ne kemi një kontratë aktive e cila është në terenë besoj që brenda një kohe të shkurtër do ti kryejë detyrimet kontraktuale dhe ashtu siq jemi dakorduar me kontraktuesin por edhe me kërkesat e qytetarëve shumica e rrugëve në qytet por edhe në fshatra do të kemi mundësi që të ndriqojmë, mirëpo është edhe një fenomenë tjetër rritja e fakturës së energjisë elektrike e cila lidhet konkretishtë me ndriqimin publik po thuhetse gjdo ditë çmimi i energjisë elektrike është duke u rritur dhe të gjithë ne që jemi këtu duhet me pasur parasysh shpenzimin.

Te tranziti i rrugës për mjetet transportuese me pesha të rënda ne e kemi marurë një vendim të cilat i kemi ndaluar që ato mos të kalojnë në qendër të Malishevës për shkakë të shumë arsyejeve e para është që mos të bëhet komunikacioni i dendur,pastaj mos të krijohetë pluhur,mos të shkaktojë pengesë për qarkullimin e kombësorëve.

Kalimin e mjeteve transportuese të rrënda i kemi vendosur në disa rrugë të tjera alternative.Këto rrugë alternative kërkojnë një mirëmbajtje sepse shumica e tyre janë të dëmtuara jashtë mase,besoj që edhe kjo pjesë e tranzitit do të rregullohetë e kemi edhe një problemë sepse një drejtim që vie nga rruga e re nga stacioni i autobusëve do ta ketë një qarkore besojë që me policinë dhe nga inspektoriati do ta aprovojnë këtë propozim dhe ky shiritë qarkullues do ti informojë me kohë të gjithë dhe kjo do të ishte më e lehtë.

Probleme me kanalizim nuk kemi vetëm në fshatin Guriq,por edhe në fshatin Pagarushë dhe në shumë fshatra të tjera të cilat kanë shpërthyer,ne e kemi një kontratë aktive dhe besoj që tani janë edhe kushtet atmosferike me të mira dhe do ti sanojmë këto defekte që janë paraqitur në kanalizim.

Procedura për prokurimin e rregullimit të rrugëve sigurishtë që buxheti i cili është aprovuar në këtë Asamble,kërkonë që ne të inicojmë disa procedura që duhet me i përfunduar disa rrugë,sigurishtë që duhet me pasur parasyshë dhe të lëvizim sa më shpejtë e të merremi me këto procedura,mirëpo ende më tutje buxheti nuk është alokuar nuk më ipet mundësia që të mirrem me këto procedura.

Publikimet të cilat dalin nga kontrata kolektive jo vetëm Komuna jonë por edhe të komunat tjera kanë shumë probleme në përmbushjen e këtyre detyrimeve sepse është një borgj që nuk është shkaktuar nga iniciativa jonë me dëshirën tonë mirëpo ai borgj është i cili është krijuar historikishtë nga komuna,prandaj ne sipas informative tona që kemi afërishtë 2.000.000.00€(dy million) mbesin që këtë vitë me i paguar,janë këto detyrime që dalin nga kontrata kolektive të cilat do të jenë një objekt i madhë për përmbushjen e projekteve të cilat i kemi votuar në këtë Asamble,janë detyrime që kanë dalur pa planifikimin tonë,detyrime kontigjente që dalin nga kjo kontratë kolektive,kjo shumë për Komunën e Malishevës është e pa përballueshme,ne kemi kërkuar dje si e kemi kuptuar nga thesari i Kosovës që është gati me i përmbushur këto detyrime që për neve është një hendikep i madh,kemi kërkuar edhe nga Kryetari i Asociacionit të Komunave përkatësishtë nga Kryetari i cili udhëheq Komunat kemi kërkuar që ta kemi një takim me Kyrministrin dhe që ti sqarojmë

eventualishtë të kërkojmë ndihmë prej tij që të na ndihmojë në përmushjen e këtyre detyrimeve kontraktuale që lidhen me kontratën kolektive.

Te mekanizimi i bujqësisë siq e dini ju ne kemi nënshkruar disa kontrata me organizata joqeveritare që kanë për synim donacionin për të ndihmuar Komunën e Malishevës të cilat kanë qëllim për përmirësimin e kushtetve të bujqësorëve.

Ajo është kontrata apo marrëveshja e cila ka dalur nga një organizatë e qeverisë së Katarit, besoj që në vazhdim edhe ju i kemi parë shpalljet për shpërndarjen e disa mekanizmave siq janë serat.

Një gjë tjetër dua të theksojë që komisioni i cili i ka shpërndarë këto donacione janë kryesishtë antarë të këtyre organizatave, përpjekja jonë që me i ndarë personave që më shumë kanë nevojë është më shumë e kufizuar në këtë rast se sa kur i shpërndanë Komuna sepse ju e dini që kur Komuna e ndanë një subvencion direct në bujqësi atëherë sigurishtë formohet komisioni dhe ne jemi përgjegjës njëqind për qind, mirëpo tek donatorët nuk lejojnë që ne të kemi qasje sepse kanë dëshirë që donacioni i tyre të shkonë në adresë në bazë të atyre kriterëve që ata kanë dëshiruar.

Sot prej orës 12:00 kemi një takim me Drejtorin e Bujqësisë dhe me antarët e organizatës joqeveritare Islamik Reliefit që më tutje të thellojmë këtë bashkëpunim besoj që sot e nënshkruajmë një marrëveshje që të marrim afërsishtë rreth shtatëdhjetë përqind nga Islamik Reliefit kurse me pjesë marrje tridhjetë përqind nga Komuna është një ndihmë apo subvencion që e bëjnë këto organizata.

Besoj që deri më tani kemi nënshkruar disa marrëveshje që Komuna e Malishevës i jep si për shembull po e themë i jep pesëdhjetë kurse i merë njëqind e pesëdhjetë, besoj që do ta thellojmë edhe më tutje këtë bashkëpunimë.

Sa i përketë te pagesat e lehonave vërtetë është një pyetje që na bëhet shumë nga qytetarët por edhe përmes rrjeteve tona sociale besoj që nuk ka kundër por kemi hendikep te përbushja e detyrimeve te kontrateve kolektive por në rast se neve na marrin përmbaruesit ashtu siq parashihet ne kemi me pasur shumë probleme te përbushja e pagesave te lohonat dhe te burrësat te studentët dhe do të kemi edhe shumë pengesa të tjera.

Urime edhe një herë mandati Asambleistëve të ri edhe kësaj Asambleje besoj që bashkëpunimi nuk do të mungojë kjo ekip e Drejtorëve që e prezantova gjithmonë do të jetë në

detyrë, transparente me përkushtim dhe me vullnet maksimal besojë që edhe më tutje do ta kemi këtë lloj bashkëpunimi.

Na priftë e mbara dhe paqim shumë sukese në organizimin e interesave të gjithë qytetarëve. Ju faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit i nderuar Kryetar i Komunës zotri Ekrem Kastrati.Urojë që mandati i juaj dhe i Drejtorëve të jetë në shërbim të gjithë qytetarëve të Komunës së Malishevës,ndërkohë kërkojë nga antarë e Asamblesë Komunale që vazhdimishtë të jeni kritikues dhe rekomandues ndaj qeverisjes komunale për shkak që kështu i shërbejmë të gjitha aktivitetet komunale dhe është më e kujdesshme ndaj gjdo vëndimi të saj.

Gjithashtu të gjithë Drejtorat Komunal i përgëzojë për angazhimin e tyre që do të vazhdojnë këtë mandate dhe të jenë shumë më të përgjegjshëm ndaj qytetarëve por edhe ndaj Asamblesë Komunale.

Vazhdojmë me pjesën e rendit të ditës.A ka dikush me marrë fjalëm?Urdhëro z.Veton.

Veton Zogaj(antarë nga rradhët e Lëvizjes Vetëvendosje):Faleminderit edhe një here Kryesues.Unë kërkojë që në rendin e ditës Kërkesa e EKO-Regjionit të largohet nga rendi i ditës sepse këtu është kërkuar ngritja e fakturës së mbeturinave,ju e dini që secila qështje që kërkonë tender financiar duhet me u trajtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe ju nuk e keni trajtuar atje,andaq nuk do ta trajtojmë këtu në Kuvend.

Prandaj kërkojë që kjo pikë të largohet nga rendi i ditës,gjithashtu edhe tek shpallja e listave për dhënien në shfrytëzim edhe këtë kërkesë nuk e kemi trajtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa.

Kjo e ka një urgjencë siq e dini kjo është dashur me u trajtuar deri para datës 31 Dhjetor por meqenëse ka qenë koha e zgjedhjeve Ministria ju ka dhënë afat deri më 31 Mars.

Kërkojë që të largohet nga rendi i ditës kjo pikë deri në seancën urgjente dhe ta trajtojmë në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe pasatj ta miratojmë.Faleminderit shumë.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Veton.A ka dikush me marrë fjalën për rendin e ditës?

Veton a e keni bazën ligjore që duhet me kaluar në Komitet për Politikë dhe Financa a e keni?

Veton Zogaj(antarë nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëventosje):Ligji për Vetëqeverisje lokale e thotë kjarë,urdhëro lexojeni që secila kërkesë që ka efektë financiarë duhet të trajtohet në Komitet për Politikë dhe Financa asnjëra prej tyre nuk është trajtuar duhet me u larguar,përndryshe unë duhet me ankimuar në MAPL(Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal).

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Ftojë zyrtarin ligjor zotri Muharrem Morina të na interpretojë për qështjen e EKO-Regjionin dhe listën e pronave për shfrytëzim.

Muharrem Morina(zyrtar ligjor në Komunën e Malishevës):Përshëndetje Kryetar,e nderuar Asamble,bord i Drejtorëve, i nderuar Nënkrjetar.Ligji për shfrytëzim të pronave publike e thotë që lista e pronave duhet të votohet në Kuvend dhe nuk thotë fare që duhet në Komitet për Politikë dhe Financa,ne nuk kemi mundur me pregaditë shkresën për shkakë që ka ardhur me vonesë,ligjërishhtë kjo listë është dashur të miratohet më datën 31.12.2025-të por për arsyeje që kanë qenë zgjedhjet në nivel lokal dhe qëndrorë,Ministria e ka shtyer afatin deri më datën 31 Mars,nuk besoj që ajo listë është dashur të kalojë në Komitet për Politikë dhe Financa sepse kjo është faza e parë dhe nuk ka implikime financiare është faza e dytë Kuvendi ose pala shprehë interesë për me i shfrytëzuar pronat publike,pastaj votohen ndarasë nëse ju mendoni për qera apo diqka tjetër.

Sa i përket kërkesës EKO-Regjionit Kryeshefi ekzekutiv e ka parashtruar kërkesën ne e kemi përcjellur në Kuvend.

Unë ju kisha rekomanduar që në parim me marrë vendimin me hyrë në këtë fazë sepse plotësim ndryshimi kërkonë procedura e cila duhet me pasur edhe debatin publikë,palët e interes duhet me i shprehë mendimet e tyre për këtë tarifë që e ka ngritur sigurishtë EKO-Regjiomi ka ngritur kostonë e shpenzimeve dhe të shërbimit është në trend kjo kërkesë e EKO-Regjionit në Komunën e Prizërenit,nëse nuk gabojë Komuna e Prizërenit e ka 7.5 në procedurë të miratimit,mirëpo në Komunën e Malishevës kushtonë më shumë për shkakë të largësisë së transportit të mbeturinave,Komuna e Suharekës është gjithashtu në procedurë të ndryshimit të taksës për

mbeturina, Komuna e Rahovecit, Dragashit janë në EKO-Regjion të cilat miren me grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave.

Besoj që para dy viteve në vitin 2023-të është ndryshuar nga 4.5 në 5.5 mirëpo ju e dini kostoja e jetesës dhe shërbimeve ka ndryshuar nga ajo kohë.

Gjatë debatit publikë vijnë ekspertët e kompanisë edhe e shpjegojnë pse ka ardhur kështu ndryshimi për ngritje të taksës kostoja ka ndryshuar do me thënë për shkakë të ngritjes së qmimit të derivateve, ka ndikuar edhe ngritja e KMDK-së, ngritja e pagave një pjesë e këtyre ka ndryshuar edhe tarifatat sepse ju e dini që Qeveria e Kosovës ka miratuar pagën minimale nga muaji Korik nëse nuk gabojë në shumën prej 500 €, kjo ka ndikuar edhe në ngritjen e pagave të puntorët e EKO-Regjionit përndryshe mundet me falimentuar kompletë kompania.

Faza e parë është preleminare për me hapur debatin me diskutuar me palët e interesit, pastaj është faza e dytë që miratohet tarifa në bazë të kërkesës së Kompanisë dhe këto janë rezultatet që dalin nga debati nga palët e interesit, në këtë rast janë qytetarët dhe bizneset kjo është faza e parë kurse faza e dytë është ajo që keni me shqyrtuar ju në Kuvend.

Veton Zogaj (antare nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje): Kryesues a mundem me marrë fjalën?

Kryesues i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Po Veton. Urdhëro.

Veton Zogaj (antare nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje): Pa dashur me marrë replikë jemi sot më datën 12 Mars nuk po e themë që mos me kaluar listën e pronave sepse nuk duhet me penalizuar listën e pronave sepse i duhet Komunës që me i dhënë në shfrytëzim por në momentin që keni me jepur në shfrytëzim patjetër që krijonë efektë financiarë, mos të bëjmë shkelje ligjore këtë po e kërkojë.

Sa i përket kërkesës së EKO-Regjionit sot kjo pikë e rendit të ditës nuk duhet me u trajtuar fare sepse ka shumë vërejtje nëse e marrim Komunën e Prishtinës si shembull ajo e ka tarifën 4.5 kurse ne e kemi 5.5 në muaj për ekonomi familjare është e shuma jashtëzakonishtë e madhe e kemi parë një raportë të përgjithshëm të kësaj kompanie që Komuna e Malishevës është numerikisht më e madhe se Komuna e Dragashit ne i kemi vetëm 5% të aksioneve aty ai ka 9%, Komuna e Suharekës i ka 19% qfarë ka ndodhur?

Mendoj që duhet me ardhur edhe kryeshefi ekzekutiv me na jepur disa sqarime para se me trajtuar një kërkesë kështu bllanko,duhet me zbritur qmimin dhe mos me i dëmtuar qytetarët.Faleminderit.

Muharrem Morina(zyrtar ligjor në Komunën e Malishevës):Qështja e aksioneve është e rregulluar me rregullorën e Qeverisë së Republikës së Kosovës,5% të aksioneve është për shkakë që njësia në Malishevë vetëm objektin e ka nuk ka asnjë pronë tjetër përveq mjeteve që përdorenë aty edhe pronën që shërbenë e ka madje me kontratë të skaduar nga Kuvendi Komunal.

Veton Zogaj(antarë nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje):Sa paguanë qiranë Komuna jonë?

Muharrem Morina(Zyrtar Ligjor në Komunën e Malishevës):Në bazë të taksave që shërbenë në bazë të kapitalit që ka njësia.Komuna e Dragashit i ka pronat e veta sepse është njësi e themeluar para luftës dhe e ka trashëguar prej njësive që e ka pasur me sistemin e kaluar ato aksionet i ka caktuar Qeveria e Republikës së Kosovës,5%i ka Komuna jonë por nuk do të thotë që nuk ndryshohet,përderisa nuk ndryshohet rregullorja ato mbesin ashtu në bazë të përfaqësimit në EKO-Regjion.

Tarifat janë në procesë në të gjithë territorin e Kosovës,jo vetëm në Komunën tonë por edhe të Suharekës.KMDK-ja e cila meret me menagjimin e mbeturinave në vitin 2023-të shuma prej 5.30€ kanë qenë shpenzimet që për një tone njësia jonë i ka paguar kur i ka dërguar mbeturinat në Landovicë tani janë mbi 7 e keni të sqaruar aty.

Për gjdo vitë ajo e ngritë tarifën e vetë sepse menagjohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës,ato tarifa i paguanë EKO-Regjioni.

Veton Zogaj(antarë nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje):Nuk kërkojë me bërë debat,por kjo pikë e rendit të ditës duhet me u shty.Ne nuk e kemi një raportë nga kjo kompani.Sa punëtorë i ka kush paguhet?

Unë mundem me i numëruar mbi dhjetë puntorë që nuk punojnë fare në mirëmbajtje por punojnë në sektorë krejtë tjetër.Kërkojë që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet dhe mos të bëjmë shkelje ligjore.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:A ka dikush për diskutim për rendin e ditës?Fjalën e ka kërku z.Halil Morina.Urdhëro.

Halil Morina(antarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Faleminderit Kryesues edhe një herë,unë në emër të partisë Nisma Socialdemokrate kërkoj që pika e 14 e rendit të ditës: Formimi i Komiteteve jo obligative,të shtyhet për mbledhjen e ardhshme,për disa arsyeje e para nuk e dimë nëse këto komitete jo obligative a do të paguhenë apo ajo dhe akoma nuk jemi të gatshëm sot që të tregojmë se cilat komitete janë të rëndësishme që të formohenë si komitete jo obligative.

Ndërsa sa i përket pikës së gjashtë: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/451 datë:03.03.2026 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, për miratim të listës së pronave të paluajtshme të komunës së Malishevës, për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026.

Unë nuk e kam të kuartë nëse në mënyrë eksplicite duhet siq e thotë Vetoni që ti nënshtrohet Komitetit për Politikë dhe Financa sepse kjo pikë është shumë e rëndësishme për ne.Dëshirojë nga Vetoni me kuptuar pse dëshironë ai që me ankimuar këtë pike,për shembull qfarë ndryshimi ka nëse nuk ka ardhur në Komitet për Politikë dhe Financa por ka ardhur direktë në Kuvend nëse nuk është e domosdoshme me ardhur në Kuvend,prandaj nëse ju ankimoni në këtë pikë dhe Komuna nuk ka të drejtë një vitë mos me shfrytëzuar asnjë pronë,tregoni qfarë fitoni nga kjo punë.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Halil.A ka dikush me marrë fjalën për rendin e ditës?Veton Zogaj e ka kërkuar fjalën.Urdhëro.

Veton Zogaj(antarë nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje):Dëshirojë të ja theme një sqarim Halilit unë nuk pata qëllim që mos me votuar por ne bëjmë shkelje ligjore nëse nuk e ankimojë.Unë nuk jam i interesuar si Asambleistë që me marur një vendim me vetëdije të plotë e me bërë shkelje ligjore.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Veton.Ne kemi diskutuar shumë qështje në Komitet për Politikë dhe Financa,vlerësojë që përveq këtyre që u thanë,atëherë ka shumë tema për tu diskutuar por vlerësojë që këtu na ndihmonë Drejtori për Ekonomi dhe Financa.E kam pasur një takim për qështjen e Komiteteve jo obligative dhe qështjen e komisionit për implikim financiar dhe Drejtori besoj që do të na jep një interpretim sot.Unë jam i mendimit që formimi i komisioneve

jo obligative të shtyhen për mbledhjen e muajit Mars,pra me kërkesën e Vetonit dhe Halilit të largohenë disa pika të rendit të ditës.

Para praktikisht nëse vetëm Drejtori për Ekonomi dhe Financa e ka marrur opinionin e saktë ligjor për pagesat e komisioneve jo obligative ja kalojë fjalën për shkak që në mandatin e kaluar kemi pasur probleme për pagesat e komisioneve.Urdhëro fjala për juve Drejtor.

Blerim Thaçi(Drejtor për Ekonomi dhe Financa):Faleminderit Kryesues.Ne jemi konsulltuar me juve,unë do të interpretojë aspektin ligjor që përveq Komiteteve Obligative të gjitha trupat e tjerë formohenë nga Kuvendi Komunal nuk kompenzohenë mirëpo ne do të shqyrtojmë mundësitë nëse ndodhë në ndonjë Komunë se cila është forma e zgjedhjes së ndonjë vendimi nga Asambleja Komunale për kompenzimin e këtyre komisioneve që formohenë,janë disa komisione të domosdoshme siq është Komisioni i KLSP-së dhe disa komitete të tjera dhe ne jemi në kontaktë me thesarin që të gjejmë një formë,një modalitet që të bëjmë kompenzimin sepse ende nuk kemi marrë një përgjigje strikte përfundimtare nuk kemi, prandaj për këtë arsyeje ju falenderojë që bërët kërkesë që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e rradhës,në mënyrë që të jemi më të saktë se a do të kompenzohen apo jo,faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit.Atëherë duke i trajtuar kërkesat e të gjithëve së bashku,besoj që pika e gjashtë e rendit të ditës,pika e nëntë,pika e dhjetë,pika e njëmbëdhjetë,pika e dymbëdhjetë,pika e katrëmbdhjetë dhe pika e pesëmbëdhjetë e rendit të ditës të largohenë nga rendi i ditës.

Enver Hoti(antarë nga rradhët e patisë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës):Përsëritje,kolegëve të cilët e jepën betimin ju urojë mandatin,juve si qeveri ju urojë mandatin detyrat,sukese dhe punë të mbarë,urojë të të realizohen ato që i keni premtuar.Kryesues nga ato që pò vërehenë është duke u parë që ky rend i ditës është formuar me nxitim ose nuk është bërë asnjë analizë para se të formulohet rendi i ditës nuk e keni përgaditur planin si qeveri dhe ju Kryesues dhe si Komiteti për Politikë dhe Financa arsyejet i dini ju.

Ju kisha lutur që mos të vijmë edhe një herë në situata të tilla me i larguar të gjitha këto pika të rendit të ditës,me shkatruar të gjithë infrastrukturën e rendit të ditës,edhe një herë nëse keni mundësi me lexuar në mënyrë eksplicite se cilat pika i keni tërhequr sepse vërehet që janë të pa përgaditura.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Sa i përket nga ana ime unë asnjë pikë të rendit të ditës nuk e largojë,por duke e parë vullnetin e Asambleistëve që kam komunikuar me secilin grup parlamentarë ata kanë deklaruar që nuk do të marin pjesë në asnjë komunitet i cili nuk paguhet,unë kam kërkuar nga Drejtori për Ekonomi dhe Financa që të na jep një interpretim ligjor për pagesat

e këtyre komisioneve, kështu jemi dakorduar që të hyrë në rend dite kjo pikë por deri në mbledhjen e ardhshme të kemi një interpretim të saktë, unë së bashku me Vetonin kemi pasur edhe disa diskutime dhe mundësi interpretimi nga nivel qendrorë, kështu që unë si Kryesues mund të vazhdojë me të gjitha këto pika të rendit të ditës të gjitha janë të pregaditura në kordinim të plotë me Kryetarin e Komunës, aty ku ka zbrastësira dhe mundësi mund të largohenë nga rendi i ditës, kështu që në bazë të vullnetit të Asamblesë bëhetë me votë.

Halil Morina (antarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate): Kryesus pika e katërtë e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/390 datë:23.03.2026 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, për formimin e Komisionit Vlerësues, me rastin e dhënies në shfrytëzim të pronës publike përmes thirrjes së interesit publik sipas vendimeve të Kuvendit nr.02/121, datë:08.03.2024 dhe nr.02/142, datë:23.05.2025.

Këtu i kemi dy vendime të ndara dhe e kemi një komision vlerësues, dëshiroj me pyetur Këshilltarin Juriki zotri Muharremin. A kemi të drejtë ligjore që me një komisionë me i mbuluar dy vendime të ndryshme?

Nëqoftëse jo, atëherë ta ndajmë këtë pikë në dy pika të rendit të ditës dhe ti formojmë dy komisione për dy vendime të veqanta. Faleminderit.

Muharrem Morina (Zyrtar Ligjor në Komunën e Malishevës): Këto janë dy vendime në fuqi, njëri vendim është miratuar në vitin 2023-të kurse tjetri është miratuar në vitin 2025-të për shkakë të zgjedhjeve kanë mbetur të pezulluara nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Të dy vendimet e veta i kanë pasur komisionet e veta aktive, në njërin komision keni qenë edhe ju Halil antarë i komisionit por në atë komison ka qenë edhe Fitimi si ekzekutiv.

Halil Morina (antarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate): Do të ishte mirë me shkruarë thjeshtë në numrin njejës dhe jo në numrin shumë për formimin e komisionit dhe jo komisionet.

Muharrem Morina (Zyrtar Ligjor në Komunën e Malishevës): Ju keni të drejtë, për këtë arsyeje i kemi shkruar dy vendime njëri në vitin 2023-të i cili ka qenë në procedurë një pjesë e saj ka filluar me u ekzekutuar dhe tjetri vendim i cili ka mbetur i pezulluar. Tani ne e kemi kërkesën për formimin e dy komisioneve që njëri ka me u merur me vazhdimin e ekzekutimit të vendimit të vitit 2023-të dhe tjetri komisionë ka me u marrur me miratimin e ekzekutimit të vendimit të vitit 2025-të. Dy komisione kanë me u marur me këto vendime sepse ligji e thotë që për gjdo vendim duhet me u themeluar një komisionë i ri.

Halil Morina (antarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate): Kërkojë që kjo të ndryshohetë dhe të ceketë që kërkohen formimi i dy komisioneve.

Kryesus i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit Muharrem për sqarimin.

Atëherë kërkojë vëmendje te pika e dytë e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -I- (parë) inauguruese të KK- Malishevë, datë: 03.12.2025, Shqyrtimi dhe miratimi

i procesverbalit të mbledhjes së -I- (parë) të jashtëzakonshme të mbajtur me datë: 30.12.2025 këto dy procesëverbale tërhiqenë për shkak që nuk i ke nënshkruar z.Enver Hoti.

Mbetën të votohenë vetëm dy procesëverbalet e fundit që të votohenë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -I-(parë) urgjente të mbajtur me datë: 12.01.2026, Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -II-(dytë) të jashtëzakonshme të mbajtur me datë: 20.01.2026,pastaj mbetën në rend të ditës që të votohet pika e tretë,pika e katër e rendit të ditës,pika e pestë,pika e gjashtë largohetë nga rendi i ditës,pika e katër ndryshohet me formulimin dhe sygjerimit e mënyrës ligjore,pika e shtatë e rendit të ditës mbetet në trajtim në seancë,pika e tetë e rendit të ditës mbetët,pika e nëntë e rendit të ditës largohet,pika e dhjetë e rendit të ditës largohet,pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës tërhiqet,pika e dymbëdhjetë e rendit të ditës largohet,pika e trembëdhjetë e rendit të ditës mbetët,pika e katrëmbdhjetë e rendit të ditës largohet,pika e pesëmbëdhjetë e rendit të ditës largohet,pika e gjashtëmbëdhjetë e rendit të ditës dhe pika e shtatëmbëdhjetë e rendit të ditës mbetenë.

Atëherë në bazë të rekomandimeve që u dhanë kush është për këtë rend të ditës?

Miratohetë rendi i ditës unanimishtë nga gjithë të pranishmitë.

Për 25 vota.

Kundër o vota.

Abstenim 0 vota.

Vazhdojmë te pika e dytë e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -I-(parë) urgjente të mbajtur me datë: 12.01.2026, Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -II-(dytë) të jashtëzakonshme të mbajtur me datë: 20.01.2026, ashtu siq u deklarova në fillim mbetën në votim vetëm këto dyja.Atëherë e hedhi në votim kush është për.

Miratohetë unanimishtë nga të gjithë të pranishmitë.

Për 25 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenim 0 vota.

Vazhdojmë te pika e tretë e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/448 datë:02.03.2026 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, në lidhje me kërkesën e Shoqatës Bamireshë “Jetimat e Ballkanit” për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Komunës së Malishevës nr.02/359, datë:11.08.2022.

Atëherë e hapi debatin me antarët e Kuvendit.Kush dëshironë me mare fjalën.Fjalën e ka kërkuar z.Burim Paqarizi.Urdhëro.

Burim Paqarizi(antare nga rradhet e Partise Demokratike te Kosovës):Pershendetje per te gjithë.Kjo kerkesë me duket se lidhet me atë qe ka qene ne mandatin e kaluar por është me disa ndryshime te vogla te cilat i vereje une.

Ne si grup parlamentarë i Partise Demokratike te Kosovës e kemi mbështetur ketë kerkesë dhe e mbështesim prapë,urojë qe ky objektë te fillojë sa me shpejtë,personat qekanë kryerë shërbime aty te jene ne formën dhe performancën me te mire te mundëshme sepse kjo është ne te mire per Komunën e Malishevës,prandaj edhe ne si Parti Demokratike e Kosovës punët e mira i vlerësojmë dhe i shtyjme përpara dhe ne jemi pro kësaj kerkesë.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit Burim.Fjalën e ka kerkuar Bashkim Krasniqi.Urdhëro fjala per juve.

Bashkim Krasniqi(antare nga rradhet e partisë Nisma Socialdemokrate):Faleminderit Kryesues.Ashtu siq e potencojë edhe parafolësi lidhur me një kerkesë qe ka qene ne Kuvend,janë zhvilluar disa procedura mirepo per shkakë te idesë së ndryshimit te projektit,llogaritjes së kapacitetit te projektit perveq qe ka qene per nevoja te ndryshme ajo është shtuar edhe per qëndrim ditor per te moshuarit dhe kështu qe është rritur kapaciteti i sajë ne ketë investim dhe është kerkuar qe te ndahet edhe sipërfaqe shtesë nga shoqata "Jetimat e Ballkanit".

Ky është një projektë me bashkëinvestim qe do me thënë edhe Komuna merë pjesë këtu,perveq pronës edhe me mjete financiare kështu qe është perkrahur nga te gjitha subjektet politike edhe ne te kaluarën por besoj qe edhe tani do te jetë disponimi per me perkrahë.

Kërkesa është qe te rritet edhe per dy hektarë dhe plani se di do te bëhet rritja ose zgjerimi i kësaj parcelle do te naret varësishtë nga projekti i cili do te bëhet nga inzhinierët e kësaj kompanie qe kanë kontraktuarë.Ky është qëllimi i kësaj kerkesë.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit.Fjalën e ka kerku Veton Zogaj,pastaj Fitmi.Urdhëro.

Veton Zogaj(antare nga rradhet e partisë Lëvizja Vetëvendosje):Faleminderit Kryesus.Në mandatin e kaluar si grup parlamentarë nga rradhet e Lëvizjes Vetëvendosje e kemi mbështetur kerkesën.Dëshirojë me ditur një sqarim meqenëse është prezentë edhe Nënkryetari këtu.

Meqenëse është bërë ndryshim a ndryshonë edhe participimi i Komunës këtu ne aspektin financiarë?Përndyshe ne e mbështesim ketë kerkesë.

Nënkryetar i Komunës z.Vesel Krasniqi:Jo nuk ndryshonë.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Veton.Urdhëro z.Fitim Shala.

Fitim Shala(antare nga rradhet e parties Lidhja Demokratike e Kosovës):Ashtu si ne mandatin e kaluar Lidhja Demokratike e Kosovës i jep mbështetje te plotë ketij vendimi.

Kjo kërkesë është për zgjerim të hapsirës dhe dihet që Komuna këtë hapsirë e jep vetëm me qira dhe prapë hapësria do të jetë në emër të Komunës edhe në këtë legjislaturë i jepim mbështetje të plotë kësaj kërkesë.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Fitim.A ka dikush nga antarët e Kuvendit me marrë fjalën?Enver Hoti e ka kërku fjalën.Urdhëro.

Enver Hoti(antare nga rradhet e partisë Aleanca për Ardhmerinë e Kosovës):Faleminderit Kryesus.Ne e mbështesim kërkesën mirëpo është dashur me i pasur ato sqarime lidhur me përmbajtjen e atyre kapaciteteve që do të shtohenë,por ne gjithësesi do ta mbështesim.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Enver.A ka dikush nga antarët e Kuvendit me marrë fjalën?Besojë që është sqaruarë kërkesa sepse e di është në lëshim të dy hekterëve tokë nga dy shkonë për katër hekterë tokë,kjo ka qenë kërkesa e shoqatës "Jetimat e Ballkanit" në mënyrë decidive.Atëherë nëse nuk ka më deklarime për këtë qështje e hedhi në votim këtë pike të rendit të ditës.Kush është për?

Miratohet kjo pikë e rendit të ditës unanimishtë nga të gjithë të pranishmit.

Për 25 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenim 0 vota.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit,vazhdojmë me pikën e katër të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/390 datë:23.03.2026 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, për formimin e Komisionit Vlerësues, me rastin e dhënies në shfrytëzim të pronës publike përmes thirrjes së interesit publik sipas vendimeve të Kuvendit nr.02/121, datë:08.03.2024 dhe nr.02/142, datë:23.05.2025.Pra do ti formojmë dy komisione vlerësuese.

Dy antarë të komisionit janë përfaqësues të Kuvendit,dy përfaqësues janë nga Kryetari dhe një antarë nga organizata jo qeveritare shoqëria civile.

Ju ftojë që të propozoni emrat e antarëve.Urdhëro z.Halil për propozim.

Halil Morina(antare nga rradhet e partisë Nisma Socialdemokrate):Faleminderit Kryesus,para se me filluar me propozimin ineqenëse i kemi dy vendime të Kuvendit është mirë me ndarë për shembull komisioni për këtë vendim me tregu sa antarë ka dhe cilët janë ata,që të ndajmë dhe mos të kemi probleme.

Muharrem Morina(Zyrtar Ligjor në Kuvendin Komunal):Së pari votohet për vendimin e 2023-të.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Pra së pari fillojmë me propozimet për antarët e komisionit për vendimin e vitit 2023-të?Pastaj vazhdojmë me tjetrën.Urdhëroni e hapi debatin.Fjalën e ka kërkuar z.Burim Paqarizi.

Burim Paqarizi(antare nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës):Para se me filluar me propozimet,pasi që edhe fjalimi i Kryetarit të Komunës ishte shumë unifikues kërkojë që të përfshihen antare edhe nga pjesa e opozitës në këto komisione,të jetë transparente për qytetarët e Komunës së Malishevës pasi që prona është e shejtë.Pra të ketë përfshirje nga gjithë Asambleja.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit.A ka dikush me marrë fjalën?Fjalën e ka kërkuar z.Bashkim Krasniqi.Urdhëro.

Bashkim Krasniqi(antare nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Dëshirojë të ndërlihem lidhur me përgjegjësinë që i kanë këto komisione për detyrat që i marrin dhe gjithmonë punën që do ta bëjnë me pasur parasysh sepse projektet tona ipen në shfrytëzim për një periudhë të gjatë siq është para para prej 99 vite mirëpo nuk do me thënë që domososhëm të ipen në shfrytëzim për 99 vite varësishtë prej veprimtarisë që zhvillohetë

.Atëherë me pasur parasysh kriteret që janë të parapara te neni 20 të rregullorës për procedurat në dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së pa lujtshme të Komunës që janë oferta ekonomikisht më e favorshme që përfshinë vlerën e investimit,numrin e të punësuarëve,llojin e investimit në interesë publikë në Komunën e Malishevës.

Përfitimi financiarë dhe ekonomikë i Komunës dhe kriteret e tjera që parashihenë në konkursë,do me thënë do të jenë po thuajse si detyra primare që duhet me i pasur parasyshë komisioni.

Përndryshe në rregull jemi për formimin e komisionit sepse i para shehë ligji këto komisione si trupa të Kuvendit për zhvillimin e procedurës së shprehjes së interesit.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Bashkim.Fjalën e ka kërkuar z.Veton Zogaj.Urdhëro.

Veton Zogaj(antare nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje):Faleminderit Kryesues.Këto dy qështje i kemi trajtuar edhe në Komitet për Politikë dhe Financa,dëshirojë vetëm një sqarim prej z.Muharremit.A kemi me pasur gjdo herë komisionë për secilën pronë? Pastaj përveqë këtyre dy komisioneve a kemi me themeluar edhe komisionin e ankesave?

Unë kisha propozuar që te komisioni i ankesave me qenë të përfshirë edhe antare nga opozita sepse nuk ka kuptim nëse pushteti i trajtonë vetëm si kërkesa pastaj edhe nëse pala ka ankesa mei trajtu prapë i njejtë komision,kështu i bije nëse janë të njejtët antare i humbet vlera.Faleminderit.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Veton.Urdhëro z.Muharrem.

Muharrem Morina(Zyrtar Ligjor në Komunën e Malishevës):Veton në më herët e kemi sqaruar por ndoshta nuk na ke kushtuar vëmendje.

Janë dy komisione e para për vendimin e vitit 2023-të e cila është në procedure e sipër,për shkakë të zgjedhjeve e kanë ndaluar vendimin tjetër.Në ligj thotë për secilin vendim për pronat publike do të formohet një komisionë i veqantë,për këtë qëllim ju kam sjelluar vendimet e viti 2023-të dhe vendimin e vitit 2025-të.

Komisioni i ankesave është pjesë e rendit të ditës si të miratohenë këto dy komisione ka me u miratuar edhe komisioni i ankesave siq e tha edhe z.Bashkimi janë komisione ligjore që kërkohenë për dhënien e pronës në shfrytëzim,keni parasysh ashtu siq e tha z.Bashkimi pa ato kritere thirja publike nuk ka vlerë.

Duke u bazuar në ato kritere ka me ardhur vlerësimi juaj me vendosur se a me dhënë apo mos me dhënë,mbi bazën e atyre kritereve Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e konfirmonë vendimin e juaj që e keni dhënë apo nuk e keni dhënë.

Te komisioni i vlerësimit dhe komisioni i ankesave nuk kanë fuqi vendim marrëse,këta kanë fuqi rekomanduse.Kuvendi ka me vendosur për me miratuar apo refuzuar ankesën.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit.Vazhdojmë me propozimet.Urdhëro z.Hafir Rexha.

Hafir Rexha(antarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Përshëndetje Kryesus.Në emër të grupit parlamentar Nisma Socialdemokrate lidhur me kërkesën me numër rendor 01/390 me datë:23.03.2026-të e parashtruar nga Kryetari i Komunës për formimin e Komisionit Vlerësues propozojë z.Halil Morinën.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit.Urdhëro znj.Xheneta Morina.

Xheneta Morina(antare nga rradhët e partisë Lidhja Demokratike e Kosovës):Unë në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës propozojë z.Fitim Shalën.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit.Janë propozuar dy emra nga antarët e Kuvendit.A ka ende propozime?Fjalën e ka kërkuar znj.Valjeta Hoti.

Valjetë Hoti(antare nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës):Faleminderit Kryesus.Ne si grup i Partisë Demokratike të Kosovës e propozojmë z.Burim Paqarizin.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Propozime të tjera nuk ka.Fjalën e ka kërkuar z.Halil Morina.Urdhëro.

Halil Morina(antarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Ky komisionë a i ka pesë antarë,njëri prej tyre duhet me qenë nga organizata jo qeveritare?

Ne zakonishtë antarët e organizatës jo qeveritare i kemi propozuarë në Kuvend dhe i kemi hedhur në votim.

A bënë me i përfunduar këta pastaj e propozojë unë një antarë nga organizata jo qeveritare?

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj: Jo, njëherë duhet me shkuar me propozimin e antarëve nga Kryetari i Komunës. Ne i kemi tre emra që janë propozuar dhe do të shkojmë me votim të ndarë për secilin kandidatë.

Kush është për që z.Halil Morina të jetë antarë i Komisionit Vlerësues për vendimin e Kuvendit nr.02/121 të datës:08.03.2024?

Për 16 vota.

Kundër 9 vota.

Abstenim 0 vota.

Kalonë propozimi për z.Halil Morina.

Propozimi i dytë është për z.Fitim Shalën kush është për?

Për 16 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenim 9 vota.

Kalonë propozimi për z.Fitim Shalën.

Propozimi i tretë është për z.Burim Paqarizin kush është për?

Për 8 vota.

Kundër 15 vota.

Abstenim 2 vota.

Me pesëmbëdhjetë vota kundër nuk kalonë propozimi si antarë i Komisionit për z.Burimin.

Kemi dy propozimet e Kuvendit dhe dy propozimet e Kryetarit të Komunës. Atëherë e hedhim në votim Komisionin Vlerësues me këtë përbërje: z.Halil Morina, z.Fitim Shala, z.Muharrem Morina dhe z.Rifat Mazreku dhe z.Veton Telaku kush është për?

Për 16 vota.

Kundër 8 vota.

Abstenim 1 votë.

Vazhdojmë me formimin e Komisionit për vendimin nr.02/142 të datës:23.05.2025-të.Urëdhoni për propozime.Fjalën e ka kërkuar z.Halil Morina.Urdhëro.

Halil Morina(antarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Faleminderit Kryesues.Në emër të grupit parlamentarë të partisë Nisma Socialdemokrate e propozojë:z.Astrit Sertollin.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Propozime të tjera a ka?Urdhëro z.Fitim Shala.

Fitim Shala(antarë nga rradhët e partisë Lidhja Demokratike e Kosovës):Në emër të grupit parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës popozojë znj.Xheneta Morina.

A ka ende emra të tjerë për propozim?Atëherë nëse nuk propozime të tjera.E hedhi në votim kush është për votimin e këtyre dy antarëve që të jenë antarë të Komisionit për Vlersim nga Kuvendi?

Për 15 vota.

Kundër 7 vota.

Abstenim 2 vota.

Me 15 vota për,kundër 7 vota dhe 2 vota abstenim kalonë propozimi,pastaj i bashkangjesim për propozim edhe emrat e propozuar nga ekzekutivi.

Atëherë i propozojë emrat e antarëve që të jenë pjesë e komisionit për vendimin me nr 02/142 e datës:23.05.2025 të cilët janë:z.Astrit Sertolli,znj.Xheneta Morina,z.Muharrem Morina,z.Rifat Mazreku dhe z.Veton Telaku.Kush është për?

Për 16 vota.

Kundër 7 vota.

Abstenim 1 votë.

Me 16 vota për.kundër 7 vota dhe abstenim 1 votë,formohet Komisioni Vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës publike.

Pika e pestë e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 01/391,datë 23.02.2026 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, për formimin e komisionit të ankesave, konform nenit 18,të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

A keni propozime për këtë pike të rendit të ditës?Fjalën e ka kërkuar z.Halil Morina.

Halil Morina(antarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Unë në emër të grupit të Nismës propozojë për këtë komision z.Hafir Rexhën.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Urdhëroni propozime të tjera.Kërkojë një propozim nga opozita.Fjalën e ka kërkuar z.Burim Paqarizi.

Burim Paqarizi(antarë nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës):Propozojë z.Demir Bajrën.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Meqenëse nuk ka propozime të tjera.Kush është për që këta dy antarë të Kuendit të jenë pjesë e komisionit?

Për 21 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenim 1 votë.

Me 21 vota për,kundër 0 vota dhe 1 votë abstenim kalojnë dy emrat e propozuarë të Kuvendit.Kalojmë me propozimet e Kryetarit.Atëherë z.Hafir Rexha,z.Demir Bajra dhe z.Fadil Shala dhe z.Valmir Gashi dhe z.Dibranë Kastrati kush për me qenë këta antarë të komisionit të ankesave?

Për 24 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenim 1 votë.

Faleminderit,miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Pika e shtatë e rendit të ditës:Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Komunal nr.01/459, datë: 04.03.2026 mbi Vlerësimin e Dëmeve nga FNFT.Ftojme që të na raportojë z.Halit Mazreku.

Halit Mazreku(Sekretar i Komisionit në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera):I nderuar Kryesues,i nderuar Kryetar,i nderuar Nënkryetar të nderuar Drejtorë,të nderuar antarë të ri të zgjedhur.

Meqenëse jam këtu për herë të parë në foltore ju urojë të gjithëve punë të mbarë.Atëherë si pasojë e rreshjeve atëmosferike të shiut me intenzitet të lartë ka bërë që nga data 05.01.2026 ka rrezikuar me përmytje te zona afër lumit të Mirusha,dhe rrezikui i qarjes së digës në liqenin e Mirushës,me kërkesën e Komandantit të Incidentit dhe Sektorit të Emergjencave,Kryetari i Komunës me vendim Nr.01/04 të dates 06.01.202604 ka aktivizuar Shtabin Emergjent Komunal për menaxhimin e Situatës Emergjente-Vërshime.

Shtabi Emergjent Komunal ka menaxhuar Situatën Emergjente-Vërshimet në përputhshmëri me akte ligjore dhe Planet Emergjente për Komunën e Malishevës.

Pas përfundimi të Situatës Emergjente, me propozimin e Sektorit të Emergjencave-DKMSH, Kryetari i Komunës duke u bazuar në Nenin 90 dhe 91 të Ligjit Nr.04/L-027 për Mbrojtje nga FNFT dhe Nenit 9 pika 2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr.17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga FNFT, me aktvendim Nr.01/27 të datës 09.01.2026 ka themeluar Komisionin Komunal për VD nga FNFT me mandate katër vjeçarë.

Me datë 12.01.2026 Sektori i Emergjencave-DKMSH ka bërë shpallje publike për afatin e lajmërimeve të dëmeve të shkaktuara si pasojë e vërshimeve për Ekonomi Familjare, Bujqësi, Biznese dhe Infrastrukturë publike dhe private me afat deri më 22.01.2026.

Pas përfundimit të afatit, Komisioni ka tërhequr nga zyra komunale për pritje gjithësej 235 aplikacione për dëmet e shkaktuara në: Bujqësi, Ekonomi familjare, Biznese dhe Infrastrukturë publike dhe private.

Prej datës 23.01.2026 deri më datën 12.02.2026 Komisioni ka bërë vlerësimin e dëmeve në terren.

Pas përfundimit të punës së vlerësimit të dëmeve në terren sipas kërkesave, Komisioni ka filluar me klasifikimin e kërkesave dhe përpilimin e formularëve për vlerësim.

Komisioni ka trajtuar të gjitha kërkesat e parashtruara në vendin e shkakimit të dëmit dhe pas plotësimit të formularëve konstaton se 57 kërkesa nuk përkojnë me Situatën Emergjente të vërshimit dhe se Komisioni nuk ka mundur të konstatojë dëme dhe si të tilla janë refuzuar.

Ndërsa dëmet e shkaktuara llogariten të jenë në shumën prej 540,523.00€

Dëmet e shkaktuara në Ekonomi Familjare llogariten të jenë në shumën prej 211,884.00 të parashtruara gjithësej 122 kërkesa.

Dëmet e shkaktuara në Bujqësi llogariten të jenë në shumën prej 8,260.00€ të parashtruara gjithësej 14 kërkesa.

Dëmet e shkaktuara në Biznese llogariten të jenë në shumën prej 109,879.00€ të parashtruara gjithësej 32 kërkesa.

Dëmet e shkaktuara në Infrastrukturë publike llogariten të jenë 210,500.00€ të parashtruara gjithësej 10 kërkesa.

Vlera totale e dëmeve të shkaktuara llogaritet të jetë në vlerën prej 540,523.00€

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj. Faleminderit z.Halit për prezentimin. Hapi debatin për diskutim për antarët e Kuvendit. Fjalën e ka kërkuar znj. Valjetë Hoti. Urdhëro znj. Valjetë Hoti fjala është për juve.

Valjetë Hoti (antare nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës): Faleminderit Kryesues. Sigurishtë që duhet bërë ky kompenzim, sepse në të kundërtën nuk ka arsyeje që të votohet

në Kuvend,por unë kam dy pyetje.A do të publikohet lista e përfituesve?Cilat kanë qenë kriteret e regjistrimit dhe a janë informuar ata që ju është refuzuar kërkesa për kompenzim?

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj.Faleminderit znj Valjetë.Fjalën e ka kërkuar z.Burim Paqarizi.Urdhëro.

Burim Paqarizi(antarë nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës):Së pari ndjejë keqardhje për të gjithë ata që kanë pësuar dëme nga fatëkeqësive natyrore që i kemi pasur gjatë vërshimeve.Uroj që ne ta votojmë dhe ta dërgojmë për Qeveri dhe të ekzekutohen sa më shpejtë të gjitha ato pagesa.

Unë ndjejë keqardhje por unë besoj që një pjesë e fajit mbetet e përbashkët edhe tek qeverisja lokale,menagjimin e ujërave nuk është duke e bërë në mënyrën e duhur tani dhe disa vite më parë.

Unë në vazhdimësi kam potencuar gabimet të cilat janë duke ndodhur në realizimin me projekte.Shpeshë ndodhë që neve na akuzojë si parti por edhe si qytetarë që në momentin që ndodhë ndonjë vërshimë po dalim në vendim e ngjarjes dhe vetëm po postojmë ,mirëpo nuk është e vërtetë sepse ne vërtetë ndjejmë keqardhje për të gjithë ata që kanë pësuar dëme.

Vërejtjet tona duhet me i marrë për bazë qeverisja lokale,përveq aspektit profesional që kam në terren gjdo ditë me punë ne e dim rezultatin dhe mënyrën se si po vijnë vërshimet,prandaj me ekzekutimet e reja të projekteve meqenëse e kemi prezentë edhe Nënkryetarin e Komunës këtu duhet të trajtohenë në mënyrën më të mire.

Unë në fillim të projekti kryesor të qendrës kam shprehur vërejtjet e mija që vërshimi i ujit vjenë nga Bjeshka Berishë.

Kompletë vërshimi i ujit një sasi e madhe e ujit fillonë menjëherë në përockën te stacioni i autobusit,me të cilën kemi pasur dëme dhe të gjitha janë të evidentuara.

Prandaj urojë që në të ardhmën,qeverisja të merret sa më shpejtë sepse kushtet atmosferike janë rregulluar dhe qytetarët mos të kenë dëmtime të kësaj natyre sepse janë shkaktuar mbi gjysmë milionë euro është një shumë e madhe nuk e di Nënkryetar se kur do të ekzekutohenë ato pagesa.Sot ne e dërgojmë për procedim por e dim që Komuna jonë nuk ka kapacitet për kryerjen e këtyre obligimeve te qytetarët për dëmet që iu kanë shkaktuarë.

Prandaj uroj që Qereria të njoftoht për gjendjen aktuale të cilën e kemi ne,qeverisja ndoshta nuk e ka gjendjen më të mirë për me ekzekutuar këto pagesa.Uroj që qytetarët tanë të marrin këto pagesa dhe këto raste mos të ndodhin më në të ardhmen.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Burim.A ka dikush me marrë fjalën?Fjalën e ka kërkuar z.Halil Morina.Urdhëro.

Halil Morina(antarë nga rradhët e parties Nisma Socialdemokrate):Faleminderit Kryesus.Faleminderit z.Mazrekut për elaborimin e këtij raporti të vërshimit.Vërshimet nuk janë shkaktuar vetëm në Komunën e Malishevës por pothuajse në tërë territorin e Republikës së

Kosovës, nuk ka dyshim që ky raportë mer miratimin tonë si grup. Shpresojmë që Qeveria e Republikës së Kosovës të kompenzojë dëmet që janë shkaktuarë ekonomive familjare edhe bizneseve.

Ajo qafërë mua më bënë përshtypje këtu, do me thënë ka qenë një vërshim këtu i jashtëzakonshëm, mirëpo ne kemi do me thënë tridhjetë e dy biznese në faktë që janë dëmtuar nga këto vërshime, në të kaluarën para se me u realizuar projekti Malisheva Urbane të gjitha bizneset përgjatë rrugës e tani te bulevardi Ibrahim Mazreku janë dëmtuar të gjitha bizneset. Sa herë që ka ra një shi ose një vërshim krejt i vogël i ka vërshuar.

Në këtë vërshim kaq të madh që ka ndodhur herën e fundit pothuajse asnjë biznes te bulevardi Ibrahim Mazreku nuk është dëmtuar, për shkakë të infrastrukturës nëntokësore që është realizuar nga projekti Malisheva Urbane. Kështu që ende ka probleme por të gjitha nuk zgjidhen menjëherë.

Kemi probleme me menagjimin e ujërave të cilat vijnë jashtë Malishevës të cilat duhet me u rregulluar në vazhdimësi e kështu punët e mira shkojnë duke u bërë pjesë pjesë e shpresojmë që herave të tjera mos të ndodhin kaq vërshime të mëdha ose që të marrim masa aq sa është e mundur prej neve prej dorës së njeriut që të ketë dëme sa më të vogla. Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Fjalën e ka kërkuar për replikë z. Burim Paqarizi. Urdhëro. Pastaj me rradhë për me marrë fjalën është z. Enver Hoti, z. Fitim Shala dhe z. Veton Zogaj.

Burim Paqarizi (anatrë nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës): E kemi diskutuar disa herë, këtu nuk shkonë me Inshallah por me majte me projekte të reja, ne e kemi aspektin politikë për me trajtuar.

Ideja është që në projektet dhe investimet e Komunës mos të kemi këto lloje të lëshimeve në të ardhmën, urojë që këto lëshime të cilat kanë ndodhur të sanohenë sa më shpejtë sepse është për të mirën e qytetarëve, ne jemi që projektet të cilat janë të mira të shtyjme përpara siq ka ndodhur në projektet e më hershme të cilat kemi votuar pro është mirë që në parim mos të kemi këto lloj telashe sepse e kemi diskutuar mbi dhjetra herë dhe do të diskutojmë sepse për këtë e kemi marrur besimin e qytetarëve. Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit me rradhë për me marrë fjalën është z. Enver Hoti, z. Fitim Shala dhe z. Veton Zogaj.

Enver Hoti (antarë nga rradhët e partisë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës): Faleminderit Kryesus. Unë dëshirojë ta falenderojë zotri Mazrekun për raportin të cilin e prezantojë, por i kam edhe disa pyetje.

I nderuar 57 (pesëdhjetë e shtatë) kërkesa janë refuzuar për qytetarët, ndoshta është mirë me pasur ndoshta një informacion më të shtuar, ne nuk e kontestojmë punën e juaj, por për informimin tonë më të rregulltë sepse ne jemi përfaqësuesit e qytetarëve dhe ata na pyesin për raportin dhe besimin tone.

Ne marrim informacione dhe është dashur me pasur një pjesë të aneksit ku kanë ngecur kërkesat e tyre. Unë në tërësi e mbështesë raportin kërkojë edhe nga ju Kryetar dhe Nënkyetar.

.Mendojë që situatën e kemi tejkaluar dhe ne e kemi mbështetur gjdo reagim të gjithë trupave reargues që kanë qenë aty të cilët janë ballafaquar me situatën e tillë sepse vërshimet që kanë paraqitur dëme shpeshë here kanë rrezikuar edhe jetën e njerëzve.

Prandaj ajo situatë kërkonë seriozitet më të madhë, kërkonë angazhim paraprakë parandalues, ka mundësi dhe elemente të cilat Qeveria do ti merrë në trajtim jashëzakonishtë profesionalë por edhe investim që mos të rrezikohet jeta, pasuria, prona e qytetarëve tanë.

Unë nuk dua të bëjë këtë qështje politike por duhet me ndërmarrë veprime konkrete dhe masa adekuate të cilat i sanojnë dhe i parandalojnë situata të rrezikshme, dëmet dhe investime e qytetarëve.

Ju e dini që edhe një herë kërkesë po ju bëjë që gjendjen e lumit Mirusha nuk në gjendje të mirë stabiliteti edhe në aspektin inzhenerikë nuk është mirë pranadje duhet të investoni që mos të vijë deri te një katastrofë që të ketë pasoja për jetën e qytetarëve. Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit. Urdhëro z. Fitim Shala.

Fitim Shala (antarë nga rradhët e partisë Lidhja Demokratike e Kosovës): Më lejoni që fillimishtë të falenderojë komisionin për verifikimin e 235 (dy qindë e tri dhjetë pesë) aplikacioneve natyrishtë që është bërë punë e madhe prej komisionit përkatës sepse është dashur të bëhenë 235 vizita, pastaj edhe rishikimi i kërkesës për vlerësimin e demit, sa i përketë kësaj kërkesës normalishtë që do ta ketë mbështetjen nga partia e Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Por jam shumë skeptikë ndaj ndihmës që do ta bëjë niveli qëndrorë, jemi dëshmitarë edhe te rasti më i freskët në Komunën e Skenderaj që qytetarët atje ende presin nga niveli qëndror për ndihmë por ende nuk kanë arritur të marrin mjetet financiare për kompenzimin e dëmeve që u janë shkaktuarë.

Ne i jepim një mbështetje të plotë kësaj, ky raport do të shkojë në nivel qëndrorë dhe duhet të presim nëse nuk do të ndajnë diçka, në emër të grupit parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës do të kërkojë ta kemë nga shefat e grupeve nga antarë e Kuvendit Komunal së bashku ta pregadisim një shkresë dhe të kërkojmë që të kryhetë kjo pagesë. Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit z. Fitim. Urdhëro z. Veton Zogaj.

Veton Zogaj (antarë nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje): Faleminderit Kryesus. E para prej dallim prej kolegëve të tjerë prej përvojës time po flas kur një situatë qfare ka qenë me vërshime e cila kërkonë trajtim shumë seriozë edhe mendojë që është bërë prej komisionit, mirëpo ajo qfarë na është pasqyruar në raportë është e kundërta e asaj qfarë po e pohonë z. Fitimi.

Në qoftëse janë trajtuar mbi 200 (dy qindë) apo 300 (tre qindë) kërkesa me një raportë të përpiluar prej një faqe e gjysmë nuk mundet me i përmbledhë. Pjesa e parë e raportit fletë vetëm për

themelimin e këtij komisioni dhe në fund me një lloj tabele që janë cekuar disa shifra 122 (një qind e njëzetë e dy)dëme janë shkaktuar në biznese e të tjera.

Nëse e dërgonë këtë kërkesë në nivelin qendrorë nuk ka si me ta miratuar aty paraqitet një tablë dhe asnjë e dhënë tjetër,në anën tjetër shuma është mbi gjysmë milioni.Me këtë lloj tabele raporti nuk krijohet ku do që ta dërgoni kështu do ta refuzojnë.

Nëse i keni trajtuar 250(dy qind e pesë dhjetë)kërkesa është mirë me i përmendur emrat e atyre bizneseve që janë dëmtuar,emrat e atyre ekonomive familjare që janë dëmtuar.

Unë mendojë që nëse situata ka qenë shumë serioze edhe raporti duhet me qenë shumë seriozë.Për mua ky raportë nuk vlenë fare,nuk e di si me trajtuar këtë.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Veton.Fjalën e ka kërkuar z.Fitim Shala për replikë.Urdhëro.

Fitim Shala(antarë nga rradhët e partisë Lidhja Demokratike e Kosovës):Unë jam shumë skeptik sa i përketë kërkesës së ndihmave që do ta bëjë niveli qendrorë.Përderisa komisioni janë puntorë të Komunës edhe ju kemi besuar në kryerjen e detyrës që kanë marrë sa i përket besimit nuk mungonë për raportin që e kanë bërë,kjo nuk është për tu marrur me imtësira është mire që ky raportë me shkuar në nivel qendrorë me bërë presion edhe ne si Asambleistë që këto dëme të paguhënë.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminder.A ka dikush me marrë fjalën?Atëherë fjalën ja kalojë z.Halit Mzrekut.

Halit Mazreku(Sekretar i Komisoit në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatëkeqësive të tjera):Falminderit Kryesus.Ky nuk është raportë është njoftim,raportin e kemi dërguar te Kryetari i Komunës nevojitet miratimi i Kuvendit për ta proceduar edhe më tutje.

Komisioni është themeluar dhe ka vlerësuar punën sipas propozimit administrativë për vlerësimin e dëmit.Sa i përket kompenzimit niveli lokal dhe niveli qendror nuk kanë fondë emergjentë të kompenzimit.Që nga viti 2021-të kompenzimi në nivel qeveritarë nuk është bërë.

Në vitin 2021 Komuna e Malishevës ka pësuar dëm në vlerën prej gjysmë milioni si pasojë e vërshimeve në shumën prej dy zetë e nëntë mijë euro apo pesë dhjetë e nëntë mijë euro nuk jam i sigurtë ka ndarë Qeveria për këto dëme.

Në vitin 2023-të Qeveria ende nuk ka bërë ndonjë kompenzim për këto dëme.Detyra jonë është me bërë raportin.I nderuar z.Enver kur ju pyetët pse janë refuzuar 57 kërkesa.Komisioni ka vlerësuar kompenzimin e dëmëve sipas kontraktimit.

Ne nuk mundemi me pranuar nëse në katin e tretë ka pasur vërshime nuk përkonë me realitetin dhe si të tillë e kemi refuzuar.

Ka pasur kërkesa të dy fishta kur një personë ka bërë kërkesa për dy apo tri prona,ka pasur raste kur kanë bërë kërkesë për infrastrukturë publike personat fizik.

Sa i përket një përgjigje për z.Veton Zogaj komisioni nuk ka mundur me i sjellur 235 dosje këtu sepse është e pamundur.

I kemi të klasifikuara të gjitha me emër,mbiemër,numër personal,numrin e biznesit,numrin e gjirologarisë bankare dhe të gjitha dokumentet e tjera të nevojshme të gjitha këto janë në fazën e fotokopjimit dhe pas miratimit të Kuvendit do të dërgohenë edhe fizikishtë në Qeveri.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:A ka dikushë nga antarët e Kuvendit me marrë fjalën.Atëherë nëse nuk ka një fjalim ka me dhënë Nënkryetari I Komunës z.Vesel Krasniqi.Urdhëro.

Nënkryetar i Komunës z.Vesel Krasniqi:Faleminderit Kryesus.Fillimishtë shfrytëzojë rastin meqenëse po marrë pjesë në këtë fillim të legjislacionit të ri, ju urojë të gjithë Asambleistëve punë të mbarë dhe sukese tani më në legjislativin e tetë si dhe juve ekzekutiv ju dëshirojë punë të mbarë.

Fillimishtë po ndalem tek tema aktuale me të vërtetë është për keqardhje që ende kemi vërshime,por jo vetëm në Komunën e Malishevës por edhe në vendet me infrastructure shumë më të zhvilluar i kanë kapluar vërshimet sepse kjo është punë e Zotit,ato nuk do të ndalënë kurrë por sigurtishtë që ne gjdo here prej pësimeve kemi marrë mësim.

Varësishtë prej kapaciteteve tona buxhetore ne i kemi zgjedhur ato.E përmendi z.Halili ku shumë prej bizneseve në të kaluarën tek bulevardi "Ibrahim Mazreku" kanë pasur nga një rigë e shiut dëme mirëpo është larguar ajo pikë e zezë,ne sigurtishtë edhe tani i kemi identifikuar pikat e zeza ne sigurtishtë nuk do të rrimë të përgjumurë,por sigurtishtë aty ku i kemi pasur pikat e zeza i kemi identifikuar dhe varësishtë prej kapaciteteve tona buxhetore ne do ti zgjidhim edhe ato.

Sa i përket projektit të madh shpeshë herë është atakuarë dikush ka bërë politikë aty por nuk është mire me bërë politikë kur kemi këto lloj raste,projketi i cili është përfunduar konkretishtë sheshi është njëri nga projektet më madhore që nga pas lufta në Komunën e Malishevës.

Një projektë i cili është jashtëzakonishtë profesional dhe i cili ka bërë zgjidhje të shumta por fakti pse ka pasur ujë teparkingu aty tek sheshi ka qenë sigurtishtë një gabim tenik edhe kjo ka qenë një pikë e zezë që tani më do të zgjidhet pasi që e kemi miratuar me buxhet ura e cila do të bëhet mbi stacionin e autobusëve.

Për shkak të kapaciteteve të mëdha të vërshimeve,gypat kanë qenë të vegjël dhe prej stacionin vërshimi ka dalur prej asaj përockës uji është futur brenda.Ju e dini të gjithë më mirë e që sigurtishtë ajo pikë do të të largohetë.

Prej të gjitha pikave,ne tani e kemi pikën andej nga rruga e Banjës te Pajtimi besojë që na merrë buxhet më shumë sepse është pikë më e ndjeshme aty,përndryshe te pikat e tjera i kemi marrë masat,Enveri e tha me të drejtë që situata vërtetë ka qenë shqetësuese dhe ne kemi pasur vizita prej nivelit qëndrorë deri tek Presidentja e Republikës së Kosovës kemi pasur vizita vazhdimishtë

për gjatë vërshimeve sepse Komuna e Malishevës është njëra prej Komunave që më së shumti është atakuar nga ato vërshimet e fundit.

Ne kemi marrë premtime nga niveli qendrorë që do të na ndihmojë, kur flasim për raporte Haliti është Kyetar i komisionit dhe ai komision ka qenë në përbërje prej pesë antarëve.

Antarët e komisionit kanë bërë një punë jashtëzakonisht të madhe të cilët unë i përgëzojë për punën e tyre, nganjëherë një raportë nuk ka rëndësi se sa faqe i ka por me rëndësi është se qfarë shkruanë aty, qfarë je duke vlerësuar aty.

Sa për njoftimin e juaj ai është një raportë prapë po e pohojë, Haliti e tha njoftim por sigurishtë është e shkoqitur apo e përmbledhur prej raportit që ne e kemi bukur vuliminozë me emër, mbiemër dhe të gjitha detajet e tjera të nevojshme që kanë pësuar dëme qoftë tek ekonomitë familjare, qoftë tek bizneset, qoftë tek infrastruktura të gjitha jemi duke i identifikuarë e që ne përveq kësaj ju kemi drejtuar edhe Ministrive përgjegjëse sidomos për lidhjen për tri ura. Ura për Gurë Bardhë, ura për Carrallukë dhe ura që është te stacioni i autobusëve kemi kërkuar dhe na është premtuar nga niveli qendrorë nga qeveria e kaluar që do të marrin masa dhe do të na mbështesin sepse kapacitetet tona buxhetore të Komunës së Malishevës janë të vogla.

Ne shpresojmë shumë që me miratimin e buxhetit në nivelin qendrorë Kuvendi i Kosovës apo Qeveria ka propozuar dhe është miratuar një fond rezervë prej tetë dhjetë milionë euro kurse ka qenë në dhjetë milionë euro dhe ne shpresojmë nga ajo shumë prej tetë dhjetë milionë do të kemi mbështetje apo mbulim ndaj këtyre dëmeve që janë shkaktuarë në infrastrukturë. Faleminderit shumë.

Kryesues i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit i nderuar Nënkyetar. Unë e përgëzojë komisionin për hartimin e raportit, ashtu siq deklarojë Sekretari se raporti zyrtarë është dërguarë në zyrën e Kryetarit të Komunës dhe ai raport është voluminozë ne sot do ta aprovojmë dhe ne do ti drejtohem më tutje organeve përgjegjëse, nivelit qendrorë për kompenzimin e dëmëve të cilat janë shkaktuarë.

Kush është për miratimin e këtij raporti?

Miratohet raporti për kompenzimin e vlerësimit të dëmëve.

Për 21 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenim 3 vota.

Pika e tetë e rendit të ditës: Formimi i Komisionit për Hartimin e Planit të Punës së Kuvendit. Ftojë të gjitha subjektet politike të propozojnë nga një antarë. Urdhëro z. Halil Morina.

Halil Morina (antare nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate): Në këtë Komisionë unë si përfaqësues i Nismës propozojë z. Gazmend Begaj.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Ftojë për propozim Partinë Demokratike të Kosovës.

Burim Paqarizi(antarë nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës):Përshëndetje ne propozojmë znj.Mërgime Robaj.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Ftojë për propozim Lidhjen Demokratike të Kosovës.

Fitim Shala(antarë nga rradhët e partisë Lidhjes Demokratike të Kosovës):Lidhja Demokratike e Kosovës propozonë znj.Xheneta Morina.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Ftojë për propozim Lëvizjen Vetëvendosje.

Veton Zogaj(antarë nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje):Ne propozojmë znj.Vlera Bytyqi

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Do të jetë antarë edhe z.Enver Hoti këtij komisioni i rekomandojë të jetë edhe z.Muharrem Morina zyrtar ligjor dhe unë si Kryesues.Kush është për që ky komision të jetë me këtë përbërje?

Miratohet unanimishtë nga të gjithë të pranishmit.

Për 25 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenim 0 vota.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Kalojmë në pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës.

Pika e trembëdhjetë e rendit të ditës: Formimi i Komisionit për ndryshim-plotësim të Statutit të Komunës.

I ftojë të gjitha subjektet politike për propozimin e një antari në komisionë.

Halil Morina(antarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Ne si grup i Nismës propozojmë z.Hafir Rexhën.

Burim Paqarizi(antarë nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës):Ne propozojmë z.Albrim Morinën.

Halil Morina(antarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Kërkojë që ta ndryshojë antarin e propozuar nga z.Hafir Rexha ta propozojë z.Bashkim Krasniqi.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Ftojë për propozim nga Lidhja Demokratike e Kosovës.Urdhëro znj.Xheneta Morina.

Xheneta Morina(antare nga rradhët e partisë Lidhja Demokratike e Kosovës):Përshëndetje në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës e propozojë z.Fitim Shalën.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Ftojë për propozim nga Lëvizja Vetëvendosje.

Vlera Bytyqi(antare nga rradhët e Lëvizjes Vetëvendosje):Nga Lëvizja Vetëvendosje propozojmë z.Veton Zogaj.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Antarë do të jetë edhe z.Enver Hoti.Propozimet e Kryetarit janë:z.Vesel Krasniqi Nënkyetar i Komunës,z.Argjend Thaçi Drejtorë i Administratës dhe z.Valmir Gashi,unë si Kryesus dhe një nga shoqëria civile prej ekspertëve të profesorëve qoftë nga Gjimnazi apo Kompetencës si dhe zyrtari ligjor z.Muharrem Morina.Kush është për Formimin e Komisionit për ndryshim-plotësim të Statutit të Komunës?Miratohet kjo pikë e rendit të ditës për Formimin e Komisionit për ndryshim-plotësim të Statutit të Komunës.

Për 22 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenime 3 vota.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Kalojmë në pikën e gjashtëmbëdhjetë të rendit të ditës.

Pika e gjashtëmbëdhjetë e rendit të ditës: Propozim- Formula për zgjedhjen e delegatëve të Komunës për Kuvend të AKK-së.

Këtu e kemi pranuar një rekomandim e keni marrë edhe ju një shkresë është sygjëruar që dy antarë duhet me qenë nga NISMA dhe një antarë nga PDK-ja.A kemi propozim ndryshe?

Atëherë presim propozimet e tyre dy nga NISMA dhe një nga PDK-ja?

Hafir Rexha(antare nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Nga Nisma Socialdemokrate propozojë shefin e grupit parlamentarë z.Halil Morina dhe z.Bashkim Krasniqi.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Ftojme për propozim antarin nga PDK-ja?

Valjetë Hoti(antare nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës):Ne e propozojmë z.Burim Paqarizin.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Atëherë nëse nuk ka propozime të tjera,i hedhim në votim kush është për z.Halil Morina,z.Bashkim Krasniqi dhe z.Burim Paqarizi?

Kalojnë tri propozimet nga Kuvendi Komunal.

Miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Për 22 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenime 3 vota.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Kalojmë te pika e shtatëmbëdhjetë e rendit të ditës.

Pika e shtatëmbëdhjetë e rendit të ditës:Të ndryshme.

E hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

Atëherë nëse nuk ka dikush me marrë fjalën,edhe një herë ju rekomandojë që të kontaktoni me kolegët e juaj Asambleistë që kanë qenë dhe të bëjnë kthimin e llaptopëve që deri në mbledhjen e ardhshme të përsërisht Asambleistët e tjerë.Faleminderit të gjithëve për pjesëmarrje.

Takimi përfundoi rreth orës:12:20

Procesëmbajtësja

Fatlume Delija



Kryesues i Kuvendit

Fatmir Ademaj

